

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

PKR.nr.125/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të rëndatrupit gjykues në përbërje nga Shadije Gërguri si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Shasivar Hoti anëtarë të trupit, procesmbajtësin Arianit Mahmutaj me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha në lëndën penale ndaj të akuzuarëve Sh.C., L.B. dhe L.S. për shkak të veprës penale Vjedhje grabitqare në bashkëveprim nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 dhe 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, L.B. dhe L.S. edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, secili veç e veç dhe A.R. për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Vjedhjes grabitqare nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 dhe 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 33 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorës Themelore në Prishtinë PP/I.nr.254/2015, të dt:28.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbalo-publik në prezencën e prokurorit të shtetit Habibe Salihu, të akuzuarit Sh.C. me mbrojtësin av.N.S. sipas autorizimit, L.B. me mbrojtësin av.R.K. i sipas autorizimit, i akuzuari L.S. me mbrojtësin av. Nasuf Hasani sipas detyrës zyrtare dhe A.R. me mbrojtësin av.D.R. sipas autorizimit, përfaqësuesuesi i palës së dëmtuar av. B.T., e dëmtuara A.R., me dt: 29.11.2017, publikisht merr dhe shpallë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

Sh.C. nga i ati F.i dhe e ema M., e vajzërisë R., i lindur me 24.08.1995 në P., ku dhe tani jeton në rr.R.G.”, jo i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, jo i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

L.B. nga i ati H. dhe e ema N., e vajzërisë V., i lindur me ... në P., ku dhe tani jeton në rr.’N. Ll.”,jo i martuar, ka të kryer shkollën fillore, jo i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

L.S. nga i ati M. dhe e ema S., e vajzërisë F., i lindur me ... në P., ku dhe tani jëton në rr. E.H., jo i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, jo i punëuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

A.R. nga i ati E., e ëma M., e gjinisë D., i lindur me ..., në P., me vendbanim në fshatin "B.", te (servisi i automjeteve R. C. M.i) K-P., jo i martuar, ka të kryer shkollën fillore, pronar i biznesit privat (me gilindera), i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Të akuzuarit **Sh.C., L.B.dhe L.S.**

JANË FAJTOR

I **SEPSE:** Të pandehurit me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme e paraprakisht kishin arritur marrëveshje gojore për të vjedhur, ashtu që me datë 30.03.2015 rreth orës 01:30 pas mesnate në qendren tregatë "A.M." në P., të pandehurit L.S. dhe L.B., pasi që fillimisht kishin marrë instruksionet nga i pandehuri Sh.C., duke u informuar mjaftueshëm nga i pandehuri Sh. për vendin se ku gjendet sefi i të hollave në kafiterinë "D.C.", sa ishte shuma e përafërt e të hollave të cilat mund të ishin në sef, për ditën kur duhet të vidhet sefi, për kohën kur duhet të vidhet, për hyrjen kah mund të hyhet pa u vërejt, takohet te rrethi i Spitalit me të pandehurin Sh., i cili me qëllim që të sigurohet se në objekt nuk mbeti askush e kishte thirru menaxherin e atij objekti që t'ia sjellë portofolin të cilin e kishte lënë me qëllim në objekt, pastaj pasi që është siguruar që në ato lokale nuk kishte mbetur askush, kishte informuar të pandehurit L.B. dhe L.S. të cilët pastaj kishin shkuar te objekti, dhe duke vepruar sipas instruksioneve të të pandehurit Sh., shkojnë tek hyrja në ndërtesën e qendrës tregtare "A.M.", hyjnë në objekt të maskuar me kapela, shall dhe dorëza, ngjiten në katin e tretë në drejtim të kafiterisë "D.C.", kanë hyrë në lokal menjëherë e kanë marrë sefin dhe pasi kanë marrë sefin kanë vërejt se tani i ndjeri N.R. është ofruar afër kafiteris, i pandehuri L.S. më qëllim që ta mbajë pasurinë e vjedhur, menjëherë më armën e tipit Ekol Special 99 e kalibrit 7.65x17 me numër serik "EV-1341927" fillimisht ka shtënë një herë në drejtim të të ndjerit, pastaj kanë filluar të përleshesh fizikisht, i pandehuri L.S. ka shtënë edhe tri herë të tjera në të ndjerin, me ç'rast tani i ndjeri goditet 4 herë, duke marrur katër palge vdekje prurëse dhe i njejt ka vdek në vendin e ngjarjes në ora 01:15 minuta nga gjakëderdhja e brendshme dhe e jashtme e cila është shkaktuar si rezultat i veprimit dinamik të predhes pasojë e goditjes me armë të zjarrit në krahorin me çrast janë demtuar organet vitale në krahoror – mushkëria e majtë e përcjellur me gjakëderdhje massive në hapësirën e lirë torokale ndersa të akuzuarit L.S. dhe L.B. largohen nga vendi i ngjarjes në drejtim të hotelit "Sh." rrugës për O.,-

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje grabitqare nga neni 328, par.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I pandehuri A.R.

II. SEPSE; Me datë 30.03.2015 me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyre të kundërligjshme, ju ka dhënë ndihmë në kryerjen e veprës Sh.C., L.S. dhe L.B., në atë mënyrë që i ka bartur me veturën e tij të tipit BMW X5, ngjyrë e zezë me numër serik ... deri në lagjen Emshir dhe të njëjtit i ka pritë derisa e kanë kryer veprën penale si në dispozitivin e parë dhe pastaj përsëri me veturën e tij i ka bartur në një hotel jashtë Prishtinës,-

- me këtë ka kryer veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vjedhje grabitqare nga neni 328 par.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

I pandehuri L.S.

III. SEPSE: Me datën 30.03.2015 në qendrën tregtare “A.M.” në Prishtinë, e ka poseduar armën e tipit Ekol Special 99 e kalibrit 7.65x17 me numër serik “EV-1341927”, pa lejen e organeve kompetente dhe në kundërshtim me ligjin mbi armë,-

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose podesim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

I pandehuri L.B.

IV. SEPSE; nga koha e pa caktuar e deri me datën 30.03.2015 në shtëpinë e tij ka poseduar armën e tipit Ekol Special 99 e kalibrit 7.65x17 me numër serik “EV-1341927”, pa lejen e organeve kompetente dhe në kundërshtim me ligjin mbi armët,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose podesim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,4,7,17,31,33,41,42,43,45,62,73,80,83 të KPRK-së dhe nenit 365, 367 , 450 dhe 454 të KPPRK-së, i gjykon,

I.Të akuzuarin **Sh.C.**

Për veprën penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit të aktakuzës vjedhje grabitqare nga neni 328, par.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjet) vite, në të cilin dënimi llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 08.04.2015 e tutje,

II. Të akuzuarit L.B.

Për veprën penale të përshkruar në pikën i të dispozitivit të aktakuzës vjedhje grabitqare nga neni 328, par.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, I përcakton DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 17 (tetëmbëdhjet) vite.

Për veprën penale të përshkruar në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, I përcakton DENIM BURGU në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 të KPK-së për dy vepra penale e gjykon me DENIM UNIK BURGU në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjet) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin denimi llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.04.2015 e tutje,

III. Të akuzuarit L.S.

Për veprën penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit të aktakuzës vjedhje grabitqare nga neni 328, par.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i përcakton DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vite .

Për veprën penale të përshkruar në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, I përcakton DENIM BURGU në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Konform nenit 80 par.1 dhe 2 të KPK-së Për dy vepra penale e gjykon me DENIM UNIK BURGU në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin denimi llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.04.2015 e tutje,

IV. Të akuzuarit A.R.

Për veprën penale Ndihmë në kryerjen e veprës penale Vjedhje grabitqare nga neni 328 par.4 lidhur me nenin 31, e lidhur me nenin 33 të KPK-së, e gjykon me DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 10 (dhjet) muaj.

Në të cilin denimi llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 08.04.2015 deri me 10.07.2017.

Ndaj të akuzuarëve Sh.C., L.B.dhe L.S. konform nenit 367 par.7 të KPPRK-së vazhdon paraburgimi deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e denimit të shqiptuar me aktgjykim.

E dëmtuara A.R.për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

DËNIMI PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së, konfiskohet arma e tipit Ekol Special 99 e kalibrit 7.65x17 me numër serik “EV-1341927”, si mjet me të cilin është kryer vepra penale, dhe e njejta duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Automjeti BMW X5, ngjyrë e zezë me numër serik ... i kthehet pronarit, pasi aktgjykimi e mrrer formën e prerë.

Të akuzuarit Sh.C., L.B., L.S. dhe A.R., obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 300 € (treqind) euro secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokurori Themelore ne Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, me aktakuzën PP/I.nr.254/2015 të datë 28.01.2016, ka akuzuar Sh.C., L.B.dhe L.S. për shkak të veprës penale Vjedhje grabitqare në bashkëkryerje nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 dhe 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, L.B.dhe L.S. edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, secili veç e veç dhe A.R. për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Vjedhjes grabitqare nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 dhe 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pasiqë të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, janë deklaruar të pafajshëm lidhur me veprat penale për kryerjen e të cilavë janë akuzuar. Andaj, meqenëse të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë lidhur me këto vepra penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurorja e çështjes Habibe Salihu në fjalën përfundimtare të dorëzuar ne formë te shkruar dhe të elaboruar gojarisht, ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar që të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar. Gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve G.P.dhe V.C. e poashtu edhe nga provat materiale siç është CD në të cilën shfaqen qartë se të akuzuarit hyjnë në lokalin D.C. dhe pastaj i akuzuari L. shtënë në drejtim të tani të ndjërët N.R., poashtu edhe nga provat tjera materiale siq janë autopsia e datë 13.04.2015, fotoalbumi mbi vendin e ngjarjes dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë e të cilat janë administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale. Më tutje prokuroja e shtetit ka pretenduar se gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzes është vërtetuar pjesërisht edhe nga mbrojtja e vetë të akuzuarve si në rastin e të akuzuarit Sh.C. i cili e ka pranuar se ka punuar në D.C. dhe se tani të akuzuarit L. dhe A. kishin shkuar në vendin e punës ku ai punonte dhe e kishin pyetur “a po bohen pare” ndërsa që ky ishte përgjigjur “po po, bohen valla”. Poshtu, i akuzuari L.S. ka pranuar faktin se ka qenë në lokalin “D.C.” para natës kritike dhe këtë e ka bërë me ftesën e tani të akuzuarit Sh. dhe atë bashkë me të akuzuarit L.B. dhe A., dhe se Sh. i kishtë treguar për hyrjen emergjente, për pazarin ditor, e poashtu se me Sh. ka kontaktuar natën kritike, ndërsa që i akuzuari A. ka qenë në dijeni të qëllimit të tyre për të shkuar me vjedhë dhe duke ditur këtë qëllim të njëjtit i ka bartuar deri të vendi i njohur si “ndërtësat e Arabëve” dhe pastaj i’u ka ndihmuar edhe pas kryerjes së veprës penale. Gjithashtu edhe i akuzuari L.B.e ka pranuar faktin se ka qenë në QT “A.M.” para natës kritike e poashtu edhe natën kritike, se paraprakisht ishin

njoftuar nga i akuzuari Sh. për vendin, kohën dhe mënyrën e hyrjes në A.M. dhe se poashtu kishin marrëveshje me të auzuarin A. për dërgimin deri të vendi i njohur si “banesat e Arabëve” me rastin e shkuarjes për të vjedhur në natën kritike dhe se poashtu se i njëjti do t’i priste pas kryerjes së vjedhjes. Andaj, nisur nga të gjitha që u thanë më lartë ka kërkuar nga Gjykata që të njëjtit t’i shpallë fajtor dhe t’i dënoj sipas ligjit, ndërsa që si rrethanë rënduesë të marrën parasysh pasojat e shkaktuara nga kjo veprë penale, siç është fakti se tanimë i ndjeri është mbajtës i familjes dhe poashtu faktin se të akuzuarit L.S. dhe L.B.edhe më parë kanë rënë ndesh me ligjin dhe poashtu ka propozuar që automjeti i tipit BMË X5 me numër serik ... në pronë të pandehurit A.R. të konfiskohet pasi që i njëjti ka shërbyer si mjet i kryerjes së veprës penale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av.B.T. poashtu në formë të shkruar gjykatës ia ka dorëzuar fjalën e tij përfundimtare e të njëjten e ka elaboruar gojarisht duke theksuar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorës së shtetit, se paraqesin kërkesë pasurore juridike mirëpo që bazën dhe lartësin e kërkesës nuk janë në gjendje ta precizojnë tani për tani, ndërsa që kërkojnë nga gjykata që të akuzuarit t’i shpallë fajtor dhe t’ua shqiptojë një dënim i cili do të jetë në përputhje me rrezikshëmërinë shoqërore të veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në përputhje me përgjegjësinë e tyre penale për secilin veq e veq.

E dëmtuara A.R.në fjalën e tij përfundimtare në tërësi e ka mbështetur fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të saj av. B.T., duke kërkuar që të akuzuarve t’u shqiptohet një dënim i merituar.

Mbrojtësit të akuzuarit Sh.C., av. N.S. në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar gojarisht ka theksuar se i mbrojturi i tij ka qenë i gatshëm ta pranojë veprën penale të ndihmes në kryerjen e veprës penale pasi që nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktakuzës ekzistojnë të gjitha elementet e kësaj veprë penale dhe në asnjë mënyrë të veprës penale vjedhje grabitqare të kryer në bashkëkryerje. Më tutje ka shtuar se kontradikta në mes përshkrimit faktik të veprimit të të mbrojturit të tij dhe cilësimit juridik të tyre konsiston në faktin se pasi që njoftimet e natyrës se ku gjendet sefi i të hollavë në kafiterinë “D.C.” se sa para ish-in në sef, në kohën kur duhet të bëhet vjedhja, janë të gjitha veprime inkriminuese që përbëjnë figurën e veprës penale të ndihmës nga neni 33 par.2 të KPRK-së, pasi që i mbrojturi i tij nuk ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të vjedhjes grabitqare dhe as që ka dashur kryerjen e të njëjtës. Më tutje ka shtuar se gjykata duhet ta ketë parasysh faktin se i mbrojturi i tij ka qenë i sinqertë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se ka treguar të vërtetën dhe nuk ka fshehur asgjë, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në një moshë të re dhe duke rënë pre e naivitetit se mund të kryejë veprë penale pa u vënë re dhe pa menduar për pasojat e veprimeve inkriminuese të ndërmarra, faktin se ka humbur prindërit në një moshë relativisht të re si pasojë e një aksidenti në komunikacion, se më parë nuk ka rënë ndesh kurrë me ligjin, se është penduar thellë dhe se pasojat e veprimit të tij i ka vuajtur shpirtërisht. Andaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana i ka kërkuar Gjykatës që të bëjë ricilësimin juridik të veprimeve inkriminuese të të mbrojturit të tij duke i cilësuar në veprë penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale dhe që në të njëjtën kohë t’i shqiptojë një dënim sa më të butë duke pas parasysh se tanimë gati tre (3) vite ka qëndruar në paraburgim, periudhe kjo e mjaftueshme për rehabilitim dhe kthim në shoqëri si pjestar i dobishëm i saj.

I akuzuari Sh.C. në tërësi e ka përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke theksuar se është i vetëdijshëm për gabimet e tij të cilat nuk do t'i përsërisë kurrë më në jetë, andaj e ka lutë Gjykatën që ndaj tij të shqiptohet një dënim sa më i butë penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.B., av.R.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se disa gjëra në këtë procesë gjyqësor kanë mbetur të pasqaruara dhe që për sqarimin e të njëjtave ka qenë e nevojshme që nga organet e ndjekjes të dëgjohej personi i cili ka qenë shef i sigurimit në objektin në të cilin ka ndodhur rasti pasi që përmes tij do të sqaroheshin se tani i ndjeri a ka qenë i trajnuar për punën që ka kryer, me çka ka qenë i pajisur dhe çfarë veprimesh është dashur të ndërmerren në rast se një apo më shumë persona kanë hyrë ilegalisht në objektin në të cilin ka qënë duke e ruajtur. Më tutje ka pretenduar se përshkrimi faktik në dispozitivin e aktakuzës është në kontradiktë me kualifikimin ligjor të kësaj gjendje faktikë të përshkruar në dispozitiv pasi që i mbrojturi i tij nuk e ka privuar nga jeta tani të ndjerin N.R., dhe se në momentin e përleshjes i mbrojturi i tij nuk ka qenë fare afër kryerësit të veprës apo tani të ndjerit N.R. dhe siç shfaqet në video incizimin, ai shihet në një moment duke ikur dhe në këto kushte nuk përmbushet elementi i bashkëkryerjes përderisa nuk ka ekzistuar as vullneti dhe as vetëdija për ta privuar nga jeta tani të ndjerin N. dhe se i mbrojturi i tij duhet të përgjigjet vetëm për veprën penale përfitim pasurorë i kundërligjshëm. Po ashtu ka shtuar se sipas legjislacionit në fuqi për të konsideruar një person i përgjegjshëm ai duhet të jetë i fajshëm dhe se në rastin konkret i mbrojturi i tij nuk është pajtuar me pasojat e veprës penale dhe nuk ka kontribuar në shkaktimin e tyre, ndërsa që fakti që i mbrojturi i tij ka pasur armë nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur edhe dëshirë edhe qëllim për të kryer vepër penale.

I akuzuari L.B. në fjalën përfundimtare në tërësi e ka përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.S., av.N.H. në fjalën e tij përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë ka theksuar se më rastin e ngritjes së aktakuzës nuk janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe të plotë veprimet e secilit prej të akuzuarve, mbështetur në provat material, pasi që nuk është përshkruar se nga kush është inicuar ideja për të hyrë e për të vjedhur në qendrën tregtare "A.M.", e poashtu fakti se i mbrojturi i tij ka hyrë për të vjedhë mirëpo jo për të privuar ndokënd nga jeta, andaj i mbrojturi i tij nuk ka dashur që ta privojë nga jeta tani të ndjerin N., mirëpo ka vepruar në afekt dhe duke qenë i sulmuar nga tani i ndjeri dhe siç është vërtetuar edhe në shqyrtimin gjyqësor e gjithë përgaditja e të mbrojturit të tij ka qenë një kapelë dhe çantë që ka pasur me vete. Më tutje ka shtuar se i mbrojturi i tij nuk ka shtënë me vullnet, vërtetohet edhe nga fakti që i njëjti ka pësuar tri plagë në trupin e tij siç vërtetohen nga raporti mjekoligjor i datë 05.05.2015, ndërsa që organi i akuzës nuk ka bërë propozim të ekzaminohet edhe gjendja psikike e të mbrojturit të tij në momentin kur ka shtënë në drejtim të viktimës. Poashtu, ka shtuar se gjendja e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës është në kundërshtim me kualifikim juridik të veprës penale pasi që sipas neni 328 par.4 të KPRK-së element kryesor i kësaj vepre penale është që kryerësi me qëllim që pasurinë ë vjedhur ta mbajë e përdor forcën apo kanosjen serioze për ta sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër e që në rastin konkret nuk jemi në këto kushte pasi që edhe pse i njëjti bashkë me tani të akuzuarin L.B. e kanë future sefin me pare në çantë, pas përleshjes me tani të ndjerin edhe pse kanë mundur ta marrin sefin, nuk e kanë marrur. Më tutje ka

shtuar se këto pretendime të mbrojtjes do të vërtetoheshin edhe përmes policëve A.Sh., A.R. dhe kolegut të tani të ndjerit V.K., kamarierin L.K. të cilët mbrojtja i ka propozuar gjykatës që të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarëve, propozime këto që nuk janë aprovuar nga gjykata, me çka është shkelur neni 10 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 6 i Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe neni 9 të KPPRK-së. Andaj i ka propozuar gjykatës që në rast së të akuzuarin L.S. e gjen fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet të marrë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë se i është dorëzuar vetë organeve të ndjekjes, se nuk ka pasur dashje në veprimet e të njëjtit, ka vepruar në gjendjes të tronditjes së fortë mendore, ka pranuar fajin për veprimet e tij faktike, ka shprehë keqardhje dhe poashtu të marrë për bazë moshën e tij të re.

I akuzuari L.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.R., av. D.R. fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë ka theksuar se nga të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se vepra penale e ndihmës si një nga format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, konsiston në dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale, dhe se në rastin konkret edhe nga deklaratat e të bashkëakuzarve të cilët kanë pohuar se i mbrojturi i tij i ka dërguar deri te vendi i njohur si “Banesat e Arabëve”, nuk hynë në veprime që i’u kanë ndihmuar apo lehtësuar të bashkëakuzuarve në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohën, pasi që është mjaft e qartë se çfarë distance të madhe kohore janë banesat e Arabëve te rrethrotullimi kryesor te Spitali nga qendra tregtare “A.M.”. Më tutje ka shtuar se lidhur me të mbrojturin e tij nuk është plotësuar as elementi subjektiv duke qenë se vepra penale e ndihmës kryhet me dashje, deri sa te vjedhja grabitqare, dashja e kryerësit për të kryer vepër penale lind aty për aty, duke qenë i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes bën veprime në drejtim të mbajtjes së pasurisë së vjedhur. Poashtu ka shtuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tij ka qenë në dijeni se i akuzuari L.B.ka qenë i pajisur me armë në momentin e nisjes për të qendra tregtare “A.M.” për të vjedhur dhe se veprimet e të mbrojturit e tij në rastin më të pavolitshëm mund të cilësohen në dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 të KPRK-së, nëse merret si i vërtetuar fakti se me veturën e tij tani të bashkëakuzuarit i ka bartur deri në një motel jashtë Prishtinës. Andaj nga se u tha më lartë i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij ta lirojë pasi që nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe poashtu të marrë vendim për kthimin e automjetit i cili i është sekuestruar të mbrojturit të tij për më tepër se dy vite.

I akuzuari A.R. në fjalën përfundimtare në tërësi e ka përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduar një nga një dhe të gjithave së bashku ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit .

Gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në bazë të deklaratës së dëshmitares/dëmtuarës A.R., deklaratave të dëshmitarëve V.C. dhe G.P. si dhe provave materiale siç janë lista e dëshmive e dt; 30.03.2015, videoinçizimi në katër CD autopsia e dt. 13.04.2015, transkripti i bisedave të L.S. e dt: 07.04.2015, transkripti i bisedave të L.B. të dt.07.05.2015, Raporti ligjor për thirrje telefonike dhe antenat për Sh.C. dhe L.B. i datë 01.04.2015 për periudhën kohore 01.03.2015 – 01.04.2015, raporti i bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit L.B.dhe L.S. të datë 04.07.2015, vërtetimi mbi konfsikimn e gjësedeve e dt: 30.03.2015, formulari i të dhënave për transferë bankarë për të ndjerin N.R., fletlëshimi me emër të ndjerit N.R., dokumentacioni mjekësorë në emër të të ndjerit N.R., vërtetimi mbi konfsikimn e gjësendeve dt.09.04.2015, formulari për ekspertim analiza e laboratorit Qendrës së kriminalistikës, dokumentacioni mjekësor i të ndjerit N.R.i dt.30.03.2015, raporti i ekspertizës dt; 27.04.2015, raporti i ekspertizës për daktiloskopinë dt.20.04.2015, Raporti i ekspertizës–analiza e ADN dt.20.04.2015, raporti i ekspertizës për analiza dhe zjarrvënie dhe eksploziv i dt.07.04.2015, ekspertiza mjeko-ligjor për të akuzuarin L.S. e dt.05.05.2015, autopsia e dt.13.04.2015, raporti nga vendi i ngjarjës 13.04.2015, si dhe raporti i autopsisë 05.02.2016, Fotoalbumet e datës 30.03.2015 dhe i dt.09.04.2015.

Dëshmitarja/e dëmtuara A.R., në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se tani i ndjeri N.R.njëherit bashkëshorti i saj në qendrën tregtare “A.M.” ka punuar rreth 9 (nëntë) vite në sigurimin e këtij objekti dhe se orari i punës së tij ka qenë nga ora 22:00 deri në ora 7 (shtatë) të mëngjesit duke punuar gjithmonë në ndërrimin e natës dhe se ata si familje nuk kanë pasur ndonjë burim tjetër të të ardhurave përveq pagës së tani të ndjerit. Më tutje dëshmitarja ka shtuar se në ditën kritike bashkëshorti tani i ndjeri N. si zakonisht nga shtëpia ka dalur rreth orës 20:00 dhe kjo dalje rreth dy orë para fillimit të orarit të punës ka qenë pasojë e shkakut se autobusi i fundit nga Hajvalia për në Prishtinë ka qenë në ora 20:00, ndërsa që tani i ndjeri asnjëherë nuk ka pasur raporte të këqija me ndokënd dhe poashtu asnjëherë nuk është ankuar lidhur me punën që ka bërë.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dëshmitari G.P., ka deklaruar së për një periudhë kohore prej 5 muajve ka punuar në cilësinë e menaxherit në kafiterinë “D.C.” në Minimax në lagjen Dragodan e cila gjendet në katin e gjashtë nga muaji nëntor i vitit 2014, ndërsa që kohë pas kohe kur ka munguar ndonjë menaxher ka punuar edhe në kafiterinë “D.C.” që gjendet në qendrën tregtare “A.M.” dhe se herë ka punuar paradite dhe herë pasdite pa një orar të caktuar, ndërkaq që puna e tij si menaxher ka konsistuar në kontrollimin e stafit, mbikëqyrjen e klienteve dhe barazimin e pazarit në fund të orarit, barazim ky që për ndërrimin e paradites është bërë në ora 16:00 kur edhe ka përfunduar orari i këtij ndërrimi, ndërsa që për ndërrimin e pasdites barazimi është bërë në ora 23:00 dhe se për shumën e të hollave pas çdo ndërrimi është bërë një raport që është dërguar në email-adresën e kafiterisë “D.C.” në të cilën ka pasur qasje i gjithë stafi, dhe pastaj paratë janë futur në një zarf dhe i njëjti është vendosur në një “kacë-sef” të veçantë më çelës që ka qenë e vendosur brenda në shank, i cili sef nuk ka qenë i rëndë, i gjerë dhe i gjatë ka qenë nga dy pëllëmbë dhe qasje në atë sef ka mundur të ketë vetëm dëshmitar, një menaxher tjetër i quajtur L. dhe menaxheri V.C., dhe se paratë në atë sef kanë qëndruar derisa drejtori gjeneral V.C.herët në mëngjes paratë i ka marrë dhe i ka dërguar në bankë ku i ka deponuar, mirëpo nuk ka qenë ndonjë ditë e caktuar për dorëzimin e të hollave në bankë pasi që ka pasur raste kur paratë në sef kanë qëndruar edhe dy-tri ditë. Më tutje ky dëshmitarë ka deklaruar se ditën kritike ai ka qenë në punë në kafiterinë “D.C.” në “A.M.”

në ndërrimin e dytë që ka filluar në ora 16:00 dhe ka përfunduar në ora 23:00 dhe se edhe në ditën kritike dëshmitari ka theksuar se ka dalur nga “A.M.” rreth orës 23:30 dhe atë ka ardhur ta marrë shoku i tij V., ndërsa që një nga punëtorët që ka punuar atë natë ka qenë edhe i akuzuari Sh.C. i cili e ka thirrur dëshmitarin në telefon dhe i ka kërkuar që t’ia sjellë kuletën që e kishte harruar. Poashtu dëshmitari fillimisht ka deklaruar se numrin e telefonit i’ a ka dhënë tani të akuzuarit Sh. me qëllimin që me pas kontakt në rast të ndryshimit të ndërrimit ose ndonjë nevojë tjetër, mirëpo pas ballafaqimit në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 26.05.2015 ku kishte deklaruar se “...së është e vërtetë se ditën kritike pak para përfundimit të orarit të punës Sh. ma kërkoj numrin e telefonit dhe unë ja kam dhënë numrin e telefonit” i njëjti ka deklaruar se është e vërtetë kjo që ka deklaruar në prokurori. Më tutje dëshmitari ka vazhduar të përshkruaj se pasi që është kthyer për ta marrur kuletën ka takuar tani të ndjerin i cili edhe e ka kontrolluar ndërsa që ky i ka treguar për arsyen e kthyerjes dhe më pastaj ka dalur nga objekti i A.M.it dhe ka vazhduar me shokin e tij V. i cili ishte duke pritur me veturën e tipit Golf 6 dhe kanë vazhduar për në Prishtinë, ku nga telefoni i shokut të tij V. e ka kontaktuar të akuzuarin Sh. dhe kanë rënë dakord që të takohen te hotel “B.” të cilit edhe i’ a ka dorëzuar kuletën, mirëpo nuk e ka vërejtur nëse i njëjti ka qenë vet apo i shoqëruar me dikë tjetër. Poashtu dëshmitari ka sqaruar se kthimin për marrjen e kuletës ka mundur ta bëjë edhe vet tani i akuzuari Sh. pasi që siç i kishte treguar dëshmitarit të sigurimit ka pasur raste kur edhe personat e tjerë i kanë harruar kuletën apo gjësendet e tjera dhe të njëjtit janë kthyer për t’i marrur nënmbikëqyrjen e sigurimit që ka bërë ruajtjen e objektit dhe poashtu dëshmitari përveq të akuzuarit Sh. me të cilin ka qenë koleg, të akuzuarit tjerë nuk i ka njohur dhe nuk ka arritur të identifikojë nëse ndonjëri nga ata ka qenë në kafiterinë “D.C.”.

I dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit V.C.në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se momentalisht punon si menaxher në Restaurantin “C.” i cili gjendet në Fushë Kosovë ndërsa që ma herët ka punuar në cilësinë e menaxherit në kafiterinë “D.C.” e cila gjendet në “A.M.”, në të cilin ka punuar në periudhën kohore 2015-2016 dhe se puna e tij prej menaxheri ka konsistuar edhe në menaxhimin e pazarit ditor që ka rezultuar në marrjen e të hollave nga kamarierët dhe vendosjen në sef, ndërsa që në mëngjes të njëjtat i ka deponuar në bankë, mirëpo sa i përket fundjavëve banka NLB ku janë deponuar paratë të shtunen ka punuar deri në ora 14:00 kur edhe është deponuar shuma e parave, ndërsa që të dielen meqenëse banka nuk ka punuar paratë nga pazari ditor kanë mbetur në sef dhe të njëjtat janë deponuar të hënën dhe se pazari më i lartë ka qenë gjatë fundjavëve, ndërsa që vetë sefi në të cilin është mbajtur pazari ka qenë i vogël diku rreth 40 cm dhe ka qëndruar në shank dhe ka qenë i përforcuar dhe se të ky sefat kanë qenë me çelës të cilët i ka mbajtur ai si menaxher dhe zëvendës i tij dhe se vetë sefi ka qenë i vendosur në një vend ku ka mundur të shihet dhe se personeli e ka ditur ku gjendet i njëjti. Më tutje dëshmitari ka pohuar se ditën kritike ai pas përfundimit të orarit të punës ka shkuar ta marrë shokun e tij tani dëshmitarin G. në A.M. diku rreth orës 22:00-23:00 të cilin e ka pritë para hyrjes kryesore të këtij objekti dhe se i njëjti ishte vonuar dhe se arsyeja e vonesës siç ishte thënë nga G. ishte fakti se kamarieri tani i akuzuari Sh.C. e ka harruar kuletën ndërkohë që nga telefoni tani dëshmitarit, G. e ka thirrur tani të akuzuarin Sh. dhe me të njëjtin janë pajtuar që të takohen te rrethi i spitalit ku edhe i’ a ka dorëzuar të njëjtit kuletën dhe se nuk ka parë nëse dikush tjetër ka qenë me të njëjtin, ndërsa që vetë dëshmitari me G. kanë vazhduar më tutje për në Fushë Kosovë. Dëshmitari poashtu ka

sqaruar se nuk e din nëse kamarierët janë në dijeni për pazarin e përgjithshëm të një ndërrimi, ndërsa që sa i përket harrimit të kuletës apo gjësendeve tjera të harruara nga punëtorët ka deklaruar se edhe nëse e njëjta ka ndodhur ata nuk kanë kërkuar prej tij të i'a sjellin kuletën mirëpo kur kanë ardhur me punë të nesërmen të njëjtat i kanë marrë.

Nga raporti i autopsisë nga zyra e mjekut ligjor me numër të references MA 15-083 të dt 05.02.2016 në emër të dëmtuarit, tani të ndjerit N.R. të punuar nga eksperti mjekoligjor N.H., konstatohet se shkak i vdekjes së tani të ndjerit ka ardhur nga gjakderdhja e brendshme dhe e jashtme, ku kjo gjakderdhje është shkaktuar si rezultat i veprimit dinamik të predhës, pasojë e goditjes me armë zjarri në krahërorë, me ç'rast janë dëmtuar organet vitale në krahëror (mushkëria e majtë), e përcjellur me gjakderdhje masive në hapësirën e lirë turakale. Vdekja ka karakter vrasës.

Nga autopsia e datës 13.04.20 konstatohet trupi i pajetë kishte qenë i mbeshtjellur me thes të najlonit me ngjyrë të bardhë (i cili shërben për bartje e trupave të pajetë). Pas hapjes së thesit shihet trupi I pajetë me shëndet të mesëm, i gjatë rreth 1.74 cm, pa flokë, sytë i kishte në pozitën e mbyllur. Në hundë kishte një dëmtim dhe nga vrimat e saj kishte rrjedhur gjaku. Viktima të veshur kishte një pallto më ngjyrë të zezë me një emblemë, në të cilin ishte mbishkrimi "S. A.M.", një këmishë me mangë të shkurta, me ngjyrë të kaltër, një maicë në formë të shkronjës "T" me ngjyrë të zezë, një maicë me krah të shkurtër me ngjyrë të bardhë. Të gjitha këto rroba kishin vrima depërtuese të cilat mendohej të jenë shkaktuar nga predhat e fishekut të armës së zjarrit. Në pjesën e poshtme, trupi i pajetë kishte të veshur një palë pantollona me ngjyrë të zezë me rrip të zi, një palë pizhame me ngjyrë të kaltër dhe një palë brekë të zeza, të mbathur kishte një palë këpucë të zeza me lidhëza si dhe një palë çorape më ngjyrë hiri. Pas heqjes së rrobave në pjesën e përparme të trupit shiheshin tri vrima hyrëse të shkaktuara nga predhat e fishekut të armës së zjarrit. Këto vrima ishin: një në pjesën e sipërmë të krahut të djathtë e cila përkonte me vrimën ndarëse nën sqetullën e po të njëjtit krahë, afër kësaj nën sqetull ishte edhe një dëmtim (djegie) e cila ka mundur të shkaktohet nga e njëjta predhë. Vrima tjetër hyrëse ishte në pjesën e sipërme të gjoksit të majtë si dhe në abdomen (ndërmjet brinjëve të anës së majtë), në shpinën e dorës së djathtë (në nyjen) e gishtit të mesëm kishte një hematomë. Në mesin e gjoksit të viktimës shihet një ndërhyrje kirurgjike e mëhershme. Në pjesën e pasmë të trupit të viktimës afër bushtit kurrizor shihet një vrimë dalëse e shkaktuar nga predha e armës së zjarrit. Ndërsa në anën e majtë të ijeve shihet një hematomë ku pas ndërhyrjes së personelit mjekoligjor është gjetur një predhë e fishekut të armës së zjarrit.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 13.04.2015 në të cilën konstatohet se vendi i ngjarjes ishte në kafiterinë "D.C.", në katin e tretë të qendrës tregtare "A.M." në Veternik, Prishtinë. Kafiteria ishte në sipërfaqë 13x10 m, në anën lindore lokali ishte i hapur pa mure, në anën jugore ishte muri i cili bënte ndarjen e lokalit në fjalë më locale P.C. Sh. Në këtë muri brenda lokalit D.C. ishin të vendosura punime me konstrukt drunor si dhe dollapët e raftet të konstruktit të njëjtë, në të cilat kishte pajisje elektronike të lokalit. Banaku shërbyes ishte me konstrukt metali dhe hapësira ndërmjet dollapëve të murit verior dhe banakut ishte 1.10m. Në dyshe-menë e kësaj hapësire ishte një çantë (shpine) me ngjyrë të zezë, me vija të kaltra, të bardha dhe të verdha, me mbishkrimin "radikal", me dimensione 45x32x13 cm. Çanta kishte katër xhepa, dy në pjesën e përparme si dhe dy në pjesën anësore (që të gjithë xhepat ishin në pozitë të hapur dhe të

zbrazur). Në brendinë e çantës ishte një kasafortë metalike, ngjyrë hiri me mbishkrimin “s.”, me numër serik “...”, me dimensionet 31x20x20 cm, e cila ishte e mbyllur me çelës. Në afërsinë e çantës ishte një gëzhojë fisheku me mbishkrim bazik “S&B7.65Br.13”, ndërsa në afërsinë e banakut shërbyes ishte një predhë e fishekut, një këllëf thike me ngjyrë të gjelbërt si dhe disa pjesë të gotave të thyera. Në raft, prapa banakut mbi kutinë e pajisjeve për ndihmë të parë ishte çelësi me numër 43034 i cili i përkiste kasafortës metalike. Në dyshtemenë e koridorit të lokaleve të cekura më lart ishte trupi i pajetë i viktimës, në pozitën e shtrirë (në shpinë) me kokën drejtë veri-perëndimit. Viktima ishte me peshë mesatare me gjatësi 1.74 cm pa flokë, me sy të mbyllur. Në hundë shihej një lëndim dhe nga vrimat e saj kishte rrjedhë gjaku. Të veshur kishte një pallto me ngjyrë të zezë, me një emblemë në të cilën ishte mbishkrimi “S. A.M.”, një këmishë me ngjyrë të kaltër me emblemenë e njëjtë. Në pjesën e poshtme të veshur kishte pantollona me ngjyrë të zezë, me rrip të zi, ndërsa të mbathura kishte një palë këpucë të zeza me lidhësa. Në pjesën e sipërme të trupit të viktimës shiheshin tri vrima për të cilat mendohet të jenë shkaktuar nga predhat e fishekut të armës së zjarrit. Vrimat ishin një në pjesën e sipërme të krahut të djathtë duke përfshirë edhe nënsqetullën e viktimës, një në pjesën e sipërme të gjoksit të majtë ndërsa një tjetër ndërmjet brinjëve të anës së majtë, në abdomen. Në pjesën e jashtme të dorës së djathtë (në nyjën e gishtit të mesëm) kishte një hematum. Lëndime të tjera në pjesën e përparme të trupit nuk shiheshin me përjashtim të një ndërhyrje kirurgjike të mëhershme në mesin e gjoksit. Në pjesën e pasme të trupit të viktimës, në anën e majtë të boshtit kurrizor kishte një vrimë depërtuese e cila ka mundur të shkaktohet nga ndonjë bredhë fisheku. Në kanalën e ijeve ishte një predhë e fishekut të armës së zjarrit. Në dyshteme, në anën e djathtë të kokës së viktimës në një largësi prej 20cm ishte një thikë me ngjyrë të zezë me mbishkrimin “U.S.A. SABER” me teh dhe me maje. Madhësia e përgjithshme e thikës ishte 22 cm, ndërsa përmasa e tehit ishte 13x3 cm, në pjesën e fundit të dorëzes kishte një busull. Në anën e djathtë të kokës së viktimës, në një largësi prej 30 cm ishte një pellg i gjakut të mundshëm me përmasa 23x22 cm. në këtë vend ngjarje ishin edhe dy gëzhoja fisheku me mbishkrimin bazikë “S&B 7.65 Br.13”, njëra gëzhoj ishte pranë lokalit “P. C. Sh.” (largësia e saj nga trupi i pajetë ishte 2.50 cm), ndërsa gëzhoja tjetër ishte ndërmjet dy hapësirave të koridorit të cilat ishin përballë dy lokaleve të cekura me parë, lartësia e saj nga trupi i pajetë ishte 2.40m në afërsinë e dverve të anës jug-perëndimore të garazhdave në qendrën tregtare A.M. ishte një çamçakëz i cili mendohet se i përket njërit nga personat e dyshuar (pasi që përmes kamerave vëzhguese shihet njëri nga ta duke pshtyer). Në murin e shkallëve emergjente kishte njolla të kuqe të ngjajshme me gjakun, ndërsa në pllakat e shkallëve kishte fragmente të gjurmëve të të mbathurave. Vlenë të ceket se në derën e depos si dhe të shkallëve emergjente nuk shihet ndonjë shenjë e hapjes së tyre me forcë, që do me thënë se dyert mund të mos kenë qenë të mbyllura me çelës. Shkallët emergjente shpinin në katin e tretë të qendrës tregtare A.M. ku dhe kishte ndodhur rasti. Kurse dyert elektronike të qendrës tregtare prej orës 23:00-07:00 hapeshin vetëm nga brenda.

Nga raporti ligjor për thirrje telefonike dhe antenave i datë 01.04.2015 i Kompanisë telefonike PTK-Vala për të akuzuarit Sh.C. vërtetohet se i njëjti në posedim të numrit të telefonit ... me datë 29.03.2015 ka komunikuar me tani të bashkëakuzuarin L.S. më numër të telefonit ... dhe atë në ora 12:52:27, 20:59:42, 22:46:13, 23:29:10, 23:54:50 dhe me datë 30.03.2015 në ora 00:12, ndërsa që me të akuzuarin L.B.me numër të telefon ... ka pasur kontakte telefonike disa ditë më herët se ngjarja kritike gjegjësisht me datë

23.02.2015 ora 23:22:44. Poashtu vërtetohet se i akuzuari Sh. me datë 29.03.2015 në ora 23:54:50 ka qenë në lokacionin e qendrës tregtare A.M., me datë 30.03.2015 në ora 24:12:30 ka qenë në lokacionin në Hajvali ndërsa që në të njëjten datë dhe orë, 9 minuta më vonë është lokalizuar në lokacionin të rrethi dhe se në të njëjten datë dhe orë, por tanimë në minutën e 56:23 sekonda ka qenë në lokacionin Kalabria.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve 2015-A2-1005 të datë 09.04.2015 konstatohet se tani të akuzuarit L.B.i është konfiskuar një pistoletë me mbishkrimin Ekol Special 99 cal.9mm P.A.K me numër serik EV-1341927 e cila është gjetur në rrugën “Ndëgjim Llumica” afër bazenit të ujit.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve 2015-A2-1005 të datë 09.04.2015 konstatohet se tani të akuzuarit L.B.janë konfiskuar një palë patike me mbishkrimin “N.”.

Nga vërtetimi mbi konfiksimin e gjëseneve 2015-A2-1005 të datë 30.03.2015 në shtëpinë e babait të tani të akuzuarit L.B.. janë konfiskuar një palë patika ngjyrë e hirit me shenjë “N.”, tri jakne, një ngjyrë e kaftë, një ngjyrë hiri, një ngjyrë e zezë, dhe një mont pa krahë ngjyrë e zezë, dy Usb njëra e kaltër me mbishkrimin “Pçi2056MB” dhe tjetra me mbishkrimin “Connected 16GB”, dy kasketa më ngjyrë të zezë njëra me mbishkrim ‘NAVY’ dhe tjetra me shenjen “Nike” dhe dy kapela të lehta njëra ngjyrë e zezë dhe tjetra e zezë me të kuqe.

Nga transkripti i bisedave të zhvilluara me datë 07.04.2015 ora 21:37:50 vërtetohet se I akuzuari L. ka zhvilluar bisedën me një person me emrin M. me këtë përmbajtje. I akuzuari L. e fillon bisedën duke thënë “o babë (nuk dëgjohet mirë) me O. jam qitu”, ndërsa që personi me emrin M. thotë “nuk ka ky pjesëmarrje, nuk o ky hiq, as ska lidhje me allti as kurgjo hiq, a ka marr pjesë po de po gjysa shyqyr që s’është ai, po leje atu, a vijmë në shpi...po ma mirë o me ardh nshpi edhe me u dorëzu vet me shkue. Ani hajdeni more gjithqysh hajde bojm llaf. Po de hajt se qe po vijmë”. Poashtu nga transkriptet e të njëjtës datë ora 21:13:36 vërtetohet se i akuzuari L.B.ka zhvilluar bisedë me nënën e tij N.B. me këtë përmbajtje, ku pasi që i akuzuari L.B. e thërret nënën e tij N.B. e pyet se a është në shtëpi një person me emrin F., ajo i përgjigjet se “jo” dhe se e gjithë biseda zhvillohet lidhur me temat që nuk janë relevante lidhur me këtë çështje penale.

Nga ekspertiza mjekoligjore e datë 05.05.2015 e punuar nga eksperti mjekoligjor F.D. lidhur me të akuzuarin L.S. konstatohet se i njëjti ka pësuar plagë prerëse sipërfaqësore të trupit, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit prerës (i mprehtë me teh) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtimet e lehta trupore dhe me dëmtime të përkohshme të shëndetit, raporti mjekësor nuk përshkruan në mënyrë të detajuar regjionet e plagëve prerëse të trupit.

Nga raporti i ekspertizës i datë 20.04.2015 i Agjensisë së Kosovës për forenzikë – Njësia për ekspertim transiologjik&daktiloskopik konstatohet se në sipërfaqe të dëshmive VN#5 - një thikë me ngjyrë të zezë me mbishkrimin U.S.A SABER, VN#9- një kallëf mbajtes i thikës me ngjyrë të gjelbërt, VN:13.1 - një kasafortë metalike, ngjyrë hiri me mbishkrimin “Safeëll” me numër serik ST “140009655” – është vepruar me metodën e avujve të supërngjitësit (Cyanoacrylatit) ku pas procesimit nuk ka pasur zhvillim – nxitje të gjurmëve të vijave papilare. Në dëshminë VN#13.1 – një kasafortë metalike ngjyrë hiri me mbishkrimin “Safeëll” me numër serik ST”140009655” pas procesimit Cyanoacrylatit është vepruar poashtu edhe me pluhur të zi alternativ, ku pas procesimit

poashtu nuk kemi pasur zhvillim – nxitje të gjurmëve të vijave papilare. Në sipërfaqe të dëshmimeve të lartëcekura VN#5, VN#9 dhe VN#13.1 nuk janë nxitur asnjë gjurmë e vijave papilare.

Nga raporti i ekspertizës e datë 20.04.2015 i Agjensisë së Kosovës për Forenzikë – Njësia e shkencave ligjore, analiza të ADN-së konstatohet se nga dëshmia VN#5 (një thikë me ngjyrë të zezë me mbishkrimin U.S.A SABER nga vendi i ngjarjes), dëshmia VN#6 (një tampon me njollë të kuqe nga vendi i ngjarjes) dhe dëshmia VN#15 (një tampon me njollë të kuqe nga vendi i ngjarjes) është fituar një profil i njëjtë i ADN-së nga një person i panjohur i gjinisë mashkullore. Ky profil nuk përputhet me ndonjë nga profilet e ADN-së në bazën e të dhënave të ADN-së. Nga dëshmia VN#17 (një tampon me njollë të kuqe nga vendi i ngjarjes) është fituar një profil i ADN-së nga një person i dytë i panjohur i gjinisë mashkullore. Ky profil nuk përputhet me ndonjë nga profilet e ADN-së në bazën e të dhënave të ADN-së. Nga dëshmia VN#13 (një çantë e zezë me vija të kaltërta të bardha dhe të verdha me mbishkrimin “Radikal” nga vendi i ngjarjes) është fituar një profil i përzier dhe i pjesërishëm i ADN-së i papërshtatshëm për krahasim. Nga dëshmia VN#1 (një çamçakëz i përdorur nga vendi i ngjarjes) nuk është fituar sasi e mjaftueshme e ADN-së për analiza të mëtutjeshme. Nga dëshmia VN#13.1 (një kasafortë metalike me mbishkrimin “Selfëell” me njollë të kaftë në njërin kënd të saj, nga vendi i ngjarjes) nuk është identifikuar ADN me origjinë njerëzore.

Nga raporti i ekspertizës për analiza, zjarrvënie dhe eksploziv i datë 07.04.2015 i Agjensionit Kosovar për Forenzikë konstatohet se nga mostrat e marrura nga dëshmitë #1.1 dhe #2.1 nuk ka mbetje të qitjes më armë zjarri me prejardhje nga baruti dhe poashtu nuk është evidentuar prani e nitratëve dhe nitritëve të cilat janë të pranishme edhe te mbetjet e qitjes më armë zjarri me prejardhje nga baruti.

Nga fotoalbumi i datës 30.03.2015 vërtetohet vendi ku ka ndodhur ngjarja me ç’rast shfaqet qendra tregtare “A.M.”, pamja nga ana jugpërendimore e kësaj qendre, një çamçakëz i gjendur në afërsi të derës jugpërendimore të garazhave të kësaj qendre dhe pastaj drejtimin e rrugës për te shkallët emergjente, pastaj hapësira e katit të tretë ku ka ndodhur rasti, pamje nga lokali “D.C.”, trupi i viktimës i cili është i shtrirë në shpinë dhe me duar e këmbë të hapura, një thikë me mbishkrimin “U.S.A SABER” e evidentuar pranë anës së djathtë të kokës së trupit të pajetë, njolla gjaku të gjitura afër trupit të viktimës, gëzhoja fisheku të evidentuara në dysHEME të koridorit pranë lokalit “D.C.” dhe Brenda banakut të të njëjtit lokal, një kasafortë metalike me mbishkrimin “Safeëell” brenda çantës së krahut.

Nga fotoalbumi i datës 09.04.2015 shfaqet vendi ku është fshehur pistoleta në anën lindore të rezervuarit të ujit në lagjen Kodra e Trimave – Prishtinë. Pastaj janë paraqitur pamjet e pistoletës së përdorur me gjithë karikator, poashtu pjesa e sipërme e pistoletës Ekol Special 99 cal.9 mm P.A.K. Më tutje shfaqen atletet me mbishkrimin “Nike” që është evidentuar në fotografinë 17-24.

Sipas listës së dëshmimeve të 30.03.2015 janë evidentuar të gjitha gjësendet të gjetuar në vendin e ngjarjes në kafiterinë “D.C.” në qendrën tregtare “A.M.” në Veternik, Prishtinë.

Nga pamjet e inxhizimit të marra nga kamerat e lokalit D.C. të datë 30.03.2015 shihet se si në minute e 4 dhe sekonden e 10 shihet se si dy persona hynë në banakun e kësaj

kafiterie ndërsa që në sekondën e 46 të së njëtit minutë njeri nga personat i cili parakrakisht ka hyrë në banak shihet se si e drejton revolën në drejtim të anës së majtë të banakut ndërsa që për një moment shfaqet një person duke ardhur nga kjo anë pra ana e majtë në një pozitë të përkulur, ndërsa që personi i cili shihet me revole shtënë përsëri në drejtim të të njëjtit, ndërkaq personi ndaj të cilit është shtënë tani i ndjeri N.R. shihet se si arrin të godas dorën në të cilën e mbante revolën njëri nga personat i cili ka shtënë në drejtim të tij dhe më pastaj shihet se si dy personat largohen nga banaku i lokalit të lartëreferuar dhe se gjatë largimit personi i cili largohet i fundit e godet viktimën ndërsa që vetë viktimja pasi që arrin të ngritet në këmbë pas disa momenteve bie përsëri dhe nuk vërehet që bën ndonjë lëvizje tjetër.

Nga raporti i qendrës së mjekësisë urgjente në Prishtinë në emër të tanimë të ndjerit N.R. konstatohet se i njëjti është pranuar pa puls, pa frymëmarrje dhe pa vetëdije.

I akuzuari Sh.C. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se të akuzuarin L.S. e njeh që nga shkolla fillore, ndërsa të akuzuarit L.B. dhe A.R. i njeh vetëm si figura të cilët kanë ardhur për të pirë kafe në kafiterinë “D.C.” ku ka shërbyer në cilësinë e kamarierit. Më tutje ka shtuar një nga herët kur L.S. ka ardhur për të pirë kafe, i njëjti e ka pyetur se çka është ai sef aty, ndërsa që ky i është përgjigjur se ka parë në atë sef dhe se nuk e ka ditur arsyen se pse tani i akuzuari L. i’ a ka bërë këtë pyetje lidhur me sefin që siç ka thënë i akuzuari ka qenë i vendosur në mënyrë provokative dhe se para ditës kritike i akuzuari L.S. ka ardhur njëherë me tani të akuzuarin A. dhe njëherë me të akuzuarin L.B. në kafiterinë “D.C.” dhe se i akuzuari L. e ka pyetur rreth pazarit ditor duke i thënë se a po bëhej punë dhe a ban me hi me vjedhë, ndërsa që ky është përgjigjur se po bahet në shumën prej 200-300 dhe 400 euro dhe se nuk ban me hy me vjedhë dhe se ky nuk e ka kuptuar se i njëjti a është duke e pyetur seriozisht apo është duke bërë shaka dhe se i njëjti e ka pyetur poashtu për hyrjet-daljet e qendrës tregtare “A.M.” dhe së bashku më të njëjtin kanë dal nga objekti dhe kanë pirë nga një cigare duke i’ a treguar kështu edhe fizikisht si dilet prej objektit, ndërsa që kur është ballafaqur në deklaratën e dhënë në Prokurori në të cilën kishte deklaruar “L. mua fare nuk më ka pyet diçka për objektin e A. si hyhet apo dilet në raste emergjente” është përgjigjur se e vërtetë është ajo që po deklaronte sot. Poashtu në ditën kritike i akuzuari ka deklaruar se tani i akuzuari L.S. e ka thirrur në telefon në orën 22:00 duke i thënë se do të vijë tek puna ta marrë dhe do të dalin për kafe dhe se i njëjti ka ardhur pasiqë ky e ka përfunduar orarin e punës dhe se bashkë me të kanë qenë tani të akuzuarit L.B. dhe A. të cilit mbiemrin nuk i’ a ka ditur dhe se poashtu kanë vazhduar për në qytet ndërsa që kur kanë zbritur nga vetura për të blerë cigare për vete dhe lëng për të gjithë, ka vërejtur se nuk e ka kuletën me vete me ç’rast e ka thirrur menaxherin e lokalit ku ka punuar dhe i ka thënë po vi po e marr kuletën mirëpo, i njëjti i është përgjigjur “rri aty pritëm te rrethi sepse unë ta bi për 5 minuta”, me ç’rast ky ka zbritur nga vetura, ndërsa që tani të bashkëakuzuarit kanë vazhduar duke rënë dakort që do kthehen pas pak për ta marrur, se kur janë kthyer ka vërejtur se veturën e drejtonte A.R., ndërsa që nuk ishin tani të akuzuarit L.B. dhe L.S. dhe se e ka pyetur tani të akuzuarin A. se ku ka mbetur L. dhe se nga i njëjti ka kuptuar se L. i ka thënë që ta lë atë te banesa ndërsa që A. të vjen ta merr tani të akuzuarin dhe të shkojnë ta marrin të akuzuarin L.S. dhe L.B. dhe se pas një kohë afërsisht 20 minutave janë takuar te “banesat e Arabëve” te rrethi i ri. Më tutje ka shtuar që pasi që tani të akuzuarit L. i dhe L.B. i kanë hyrë në veturë, të akuzuarit L.S. i’ a ka parë një armë në dorë dhe se i njëjti ka bërë titur “grahni kerrit, grahni kerrit”, arma ka qenë ngjyrë e bardhë mirëpo nuk i’ u kujtohet se në

cilën dorë e ka pasur dhe se ai dhe i akuzuari A. e kanë pyetur se çka ka ndodhë, ndërsa që i akuzuari L. i është përgjigjur duke bërë titur “grahni kerrit, grahni kerrit se po më duket e kam vra dikënd” dhe se i akuzuari kur ja ka pa gjakun në trup të akuzuarit L., i ka thënë A. “hajde ta qojmë te mjeku mos e ka vra najkon” dhe se pasi që i akuzuari L. nuk ka pranuar me shku te mjeku së bashku kanë vazhduar rrugën për Obiliq tek një motel në Dragodan në të cilin kanë hy brenda, mirëpo i akuzuari ka deklaruar se nuk e ka ditur se tani të akuzuarit L.S. dhe L.B. kanë qenë në qendrën tregtare “A.M.”, ndërsa që pasi që është ballafaquar me deklarin e dhënë në prokurori me datë 01.09.2015 ku kishte deklaruar “L. edhe pse ishte i lënduar më tregoj dhe më tha se kemi hyrë në lokalin tonë dhe më tha se kemi dashtë me i marrë paret dhe kemi gjujt” është përgjigjur se nuk i kujtohet se ka thënë kështu ndoshta prokuroria e ka shënuar gabim, mirëpo pas prezentimit në vështrim ka pohuar se nënshkrimi është I tij në gjdo faqë të procesverbalit të dhënës së deklaratës. Ka deklaruar se i ka ndodhë edhe më herët që në vendin e punës t’i harroj çelsat e shtëpisë apo telefonin mirëpo nuk ka shkuar t’i marrë pasi që ka pasur nesër në mëngjes me u kthyer përsëri në punë. Më tutje i akuzuari ka sqaruar se nuk i kujtohet nëse ky i’ a ka kërkuar numrin menaxherit G.P. apo nëse i njëjti i’ a ka dhënë vet dhe se nuk i kujtohet se cilën koleg e ka zëvendësuar, mirëpo i ka zëvendësuar ashtu siç i është kërkuar nga menaxheri.

I akuzuari L.B. në mbrojtjen e paraqitur në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se përveq të akuzuarit L.S. e ka njohur tani të akuzuarin Sh.C. të cilin e njeh që nga shkolla fillore ndërsa që të akuzuarin A. e ka njohur përmes tani të akuzuarit L. i. Ideja për të hyrë në kafiterinë ‘D.C.’ me qëllim të vjedhjes së kasafortës me para ka qenë e tani të akuzuarit L.S. i cili e ka thirrur ku edhe janë takuar me ç’rast i akuzuari L. e ka pyetur “a po vjen me mu për me shku me vjedhë ni kasafortë me pare” dhe se para ditës kritike ata dy ose tri herë ata kanë qenë në kafiterinë e lartpërmendur pasi që L. i ka dashtë me shiku se ku është kasaforta dhe se ai me të akuzuarin L. janë ulur në terrasë, ndërsa që tani i akuzuari L. gjatë kohës sa kanë qëndruar në atë vend është ngritur nga tavolina me qëllim që të shohë se ku gjindet kasaforta dhe siç i ka treguar tani i akuzuari L. i njëjti ka dal me të akuzuarin Sh. dhe poashtu tri ose katër ditë para ngjarjes kritike ai, i akuzuari Sh. dhe L. janë takuar në një kafiteri te “Hani i Dilit”, i akuzuari nuk e ka degjuar bisedën që është zhvilluar mes të akuzuarit Sh. dhe L., mirëpo siç i ka treguar ky i fundit, të njëjtit kanë biseduar që ai dhe L. i me shku në “A.M.”. Më tutje ka shtuar se në ditën kritike rreth orës 19-20:00 ai dhe i akuzuari L. kanë qenë te lokali “Hani i Dilit” ku dhe i akuzuari L. e ka thirrë në telefon A. in i cili ka ardhur dhe i ka marrur, dhe me të cilin kanë shetitur deri rreth orës 23:00-24:00, kur edhe kanë ardhur te “banesa e Arabëve”, me ç’rast i akuzuari L. e ka thirrur të akuzuarin Sh. në telefon dhe e ka pyetur se kur e kryen punën, ndërsa që se Sh. i është përgjigjur edhe pak, dhe pas pak kohe i akuzuarin Sh. përmes telefonit e ka njoftuar të akuzuarin L. se ka përfunduar punën dhe ata janë nisur në drejtim të A.M. me qëllim që ta marrin të njëjtin, ndërsa që gjatë kthimit pasi që e kanë marrë të akuzuarin Sh. kur kanë arritur te banesat e Arabëve i njëjti ka treguar se ka harruar kuletën, me ç’rast edhe e ka thirrur menaxherin me qëllim që t’ia sjellë kuletën dhe i akuzuari Sh. ka dalur nga vetura me qëllim që ta pret menaxherin e vet, ndërkohë ata janë kthyer e kanë marrë të akuzuarin Sh. dhe të gjithë së bashku kanë vazhduar për tek banesat e Arabëve dhe se gjatë gjithë kësaj kohe veturën e ka drejtuar L.S. dhe se gjatë kohës sa kanë shkuar te banesat e Arabëve është biseduar rreth qëllimit për të shkuar me e kry vjedhjen në A.M.. Më tutje ka shtuar se rreth orës 24:00 kanë shkuar në

qendrën tregtare “A.M.” me tani të akuzuarin L., ndërsa që deri te “banesat e Arabëve” i kanë dërguar tani i akuzuari A.R. me veturën e tipit BMË X5 të cilën edhe e ka drejtuar, ndërsa që qëllimi i shkuarjes në A.M. ka qenë vjedhja e kasafortës në kafiterinë “D.C.” që siç i kishte treguar L.S. gjenden diku rreth 7000-8000 euro të cilët kanë pasur për ti ndarë në katër pjesë dhe atë për vetë të akuzuarin, pastaj për të akuzuarit tjerë A., L. dhe Sh. dhe se kur janë nisur me shku në “A.M.” ka qenë i bindur se aty nuk gjendet asnjë njeri, ndërsa që në vetë objektin kanë hyrë përmes derës emergjente, kanë vazhduar shkallëve lartë deri te kafiteria “D.C.” dhe se vetë ata kanë pasur të vendosura maska me ngjyrë të zezë në formë të kapelës, e cila i ka pasur vetëm dy vrima tek sytë, ndërsa që pjesa tjetër e fytyrës ka qenë e mbuluar dhe sigurisht që qëllimi i vendosjes së maskës ka qenë për të mos u identifikuar meqenëse e kanë ditur se në objekt kanë qenë të vendosura kamera. Sa i përket revolës i akuzuari ka theksuar se revolja ka qenë e tij dhe se të njëjtin e ka mbajtur pasi që ka pasur probleme me disa persona nga Kolovica dhe se në natën kritike të njëjtën e ka pasur në posedim deri te “banesat e Arabëve” kur edhe të njëjten i’a ka dhënë të akuzuarit L. për shkak se ka pasur të veshura trenerka dhe nuk ka mundur ta mbajë dhe e ka ditur se më revole ka fishek por nuk e ka ditur numrin e fishekëve dhe se me rastin e dhënies së revolës nuk kanë biseduar nëse të njëjten do ta përdorin në qendrën tregtare “A.M.” dhe pasi që kanë zbritur nga vetura tek vendi i quajtur “banesat e Arabëve” kanë vazhduar këmbë për tek QT “A.M.” pasi që janë frikësuar se mos vetura po inçizohet nga kamerat që kanë qenë të vendosura aty. Sa i përket momentit kritik I akuzuari ka përshkruar se ka pasur një çantë të shkollës me vete me qëllim që në të njëjten ta fusë kasafortën të cilën ka qenë duke e vendosur L. dhe për një moment i akuzuari ka pohuar se e ka parë duke ardhur një person në drejtim të tyre , ka ardhur në mënyrë të kërrysur , me ç’rast i akuzuari është larguar në drejtim të fundit të shankut, ka hipë mbi shank dhe distanca mes tij dhe personit ka qenë 4-5 metra, ndërsa që L.i ka mbetë te dera e shankut të cilin edhe e ka sulmuar ky person me një thikë i cili ka hyrë brenda në shank dhe se në momentin kur ka krisë arma ai ka qenë larg dy-tri metra nga ai vend dhe në atë moment ka ikur L.i dhe pas tij ka ikur edhe i akuzuari nga e njëjta rrugë që edhe kanë hyrë, pra nga dera emergjente dhe së bashku janë nisur në drejtim të banesave të Arabëve, ka hoteli “A.” pasi që e ka ditur që janë duke i pritur tani të akuzuarit Sh. dhe A., ndërsa që gjatë rrugës i akuzuari L. ka treguar se ka qenë i therur në kukë, në pjesën e barkut anash dhe në krah, ndërsa që pas ballafaqimit në deklaratën e dhënë në Polici “...ndërsa që unë isha duke ikur ai person më ka kapur për këmbë, ku edhe më ka shkyer trenerken poshtë dhe unë arrita të ikë shkallëve poshtë” ka deklaruar se nuk ka përgjigje. Më tutje i akuzuari ka shtuar se pasi që kanë hyrë në veturë i akuzuari L. i’a ka dhënë armën Sh. dhe aj atë armë përseri e ka këthyr të nesermit dhe të gjithë së bashku kanë vazhduar për tek një motel emri I të cilit nuk I është kujtuar dhe armë të nesërmen e ka marrur i akuzuari dhe së bashku me L.in e kanë fshehur tek bazeni i ujit. Ka shtuar se nga moteli së bashku me L.in kanë shkuar në fshatin K. , tek shtëpija e axhës së tij e cila ka qenë e pabanueshme dhe deri në atë vend kanë shkuar me një veturë të shokut.

I akuzuari L.S. në mbrojtjen e paraqitur në seancen e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të akuzuarin Sh.C. e ka pasur në klasë në shkollën fillore për gjashtë vite, të akuzuarin L.B. e ka pasur në paralele në shkollë dhe njëherit shokë të mahallës, ndërsa të akuzuarin A. e njeh sepse lokali i familjes së tij dhe lokali I të akuzuarit A. janë në afërsi. Më tutje ka shtuar se aryeja e vetme që kane shkuar në QT “A.M.” në natën kritike ka qenë për me

vjedh kasafortën, duke qenë në dijëni se në të njëjtin gjendë shuma prej 10 deri në 15 mijë euro, fakt ky që i është thënë nga i akuzuari Sh. i cili ka punuar në kafiterinë “D.C.” në QT “A.M.”. Më tutje i akuzuari ka vazhduar duke pohuar se para ditës kritike ka shkuar dy herë në kafiterinë “D.C.” në A.M. i ftuar nga i akuzuari Sh., herën e parë me A.R. dhe herën e dytë me të akuzuarin L.B., pasi që paraprakisht e kishte thirrur i akuzuari Sh. për të treguar se ka me hy në QT “A.M.” konkretisht në kafiterinë “D.C.” nëpërmes hyrjes emergjente dhe se kur kanë qëndruar në kafiterinë “D.C.” kanë qenë ulur afër shankut dhe nga ai vend kanë mundur ta shohin sefin, ndërsa që i akuzuari Sh. ka qëndruar kohë pas kohe me të njëjtin dhe së bashkë me të kanë shkuar drejt hymjes emergjente në katin e tretë ku ka qenë një derë e vogël edhe përmes saj kanë zbrit poshtë shkallëve deri tek dera që dërgon tek dalja nga objekti ku edhe kanë konsumuar nga një cigarë dhe kanë biseduar për mënyren se si më hy në objekt dhe fakti se pse kanë vendosur që vjedhja të kryhet ditën e dielë është për shkak se ai, L.B. i dhe A. i kanë qenë të informuar nga i akuzuari Sh. se pazari që kryhet ditën e dielë, deponimi i këtyrë të hollave bëhet të hënen në mëngjes nga menaxheri. Ditën kritike pasi që fillimisht është thirrur nga i akuzuari Sh. dhe është pyetur se a jeni gati dhe i është thënë se mirë është puna dhe se duhet më ardhë gjithqysh, më pastaj është takuar me të akuzuarin L.B. në kafiterinë “H. i D.” rreth orës 19:00 dhe pas gjysmë ore ai ka thirrur të akuzuarin A. i cili ka ardhur për 10-15 minuta dhe bashkë me të njëjtin kanë qëndruar deri rreth orës 22:00 dhe pastaj që të tre kanë vazhduar për në qendrën tregtare A.M. ku edhe kanë marrur edhe tani të akuzuarin Sh., ndërsa që duke ardhur për në Prishtinë i akuzuari Sh. i’u ka thënë se kinse ka harruar kuletën pasi që i’u ka thënë “e lash kuletën me qëllim që me thirrë më ma pru kuletën, për me ditë kur del ai sepse i njëjti u met mrena edhe për pak kohë”, me ç’rast i akuzuari Sh. e ka thirrur menaxherin dhe të njëjtit kanë rënë dakord që të takohen tëk rrethi kryesor në Prishtinë, ku i akuzuari Sh. ka dalë nga vetura ndërsa që të akuzuarit tjerë e kanë pritur në anën tjetër të rruges dhe se menaxheri nuk ka mundur të i shohë të njëjtit. Më tutje ka shtuar se i akuzuari A. bashkë me Sh.in i kanë dërguar deri tek vendi i quajtur “banesat e Arabëve” pasi që ashtu ka dashur i akuzuari A. duke u frikësuar se “mos po e rrokë ndonjë kamerë” dhe se në momentin kur ka dalur nga vetura të gjithë të akuzuarit e kanë ditur se i akuzuari L.B. ka revole dhe pasi që i akuzuari L.B. ka pasur të veshur trenerka dhe alltinë që e ka pasur me vete nuk ka mundur ta mbajë, të njëjten i’a ka dhënë tani të akuzuarit dhe kanë vazhduar për në QT “A.M.” duke menduar se në të gjendet vetëm një sigurim dhe ai është në pjesën ku janë kamerat që siç i’u kishte thënë i akuzuari Sh. personi është i moshuar. Poashtu ka shtuar se kanë pasur kapelat me ngjyrë të zezë të cilat kanë qenë në formë të maskës dhe dorëza në dorë. Paraprakisht e kanë kapërcue rrethojen e objektit A.M. e pastaj nëpërmesë hyrjes emergjente kanë hyrë në objektin Te A. janë ngjitur nalt shkallëve dhe gjatë ngjitjes përmes shkallëve për një moment janë ndezë dritat dhe pastaj kanë vazhduar për në katin e tretë drejtë kafiterisë “D.C.”, kanë hyrë brenda shankut në vendin ku kanë qenë të informuar se gjendet sefi, i akuzuari e ka marrë të njëjtin dhe duke e vendosur në çantën të cilën ka qenë duke e mbajtur i akuzuari L.B., e ka vërejtur një person, me ç’rast i akuzuari e ka nxjerrur revolën në të cilën nuk e ka ditur se a ka dhe sa plumba janë dhe në një distancë 1 metër e gjysmë ose 2 metra ka gjuajtur një herë në revole në dysheme me qëllim që ta frikësoj personin, mirëpo personi duke mbajtur në dorë një thikë ka hyrë në shank dhe tani të akuzuarin e ka goditur në pjesën e barkut në krahëror dhe kukë, ndërsa që i akuzuari ka vazhduar me gjujt me revole dhe nuk ka parë se ku po gjun dhe vetëm është

munduar ta shpëtojë vetën, për një moment është rrëzuar në tokë me shpinë dhe poashtu është rrëzuar edhe personi tjetër, i akuzuari është ngritur dhe ka filluar të ikë në drejtim të hyrjes emergjente nga edhe kishte ardhur, derisa i akuzuari L.B. ka ardhur pas tij dhe së bashku kanë vazhduar deri te Restaurant A. dhe meqenëse i akuzuari nuk ka mundur të ecë, i akuzuari L.B. ka shkuar dhe i ka thirrë tani të akuzuarit A. dhe Sh. të cilët kanë ardhur dhe e kanë marrur te hotel “V.” dhe të gjithë së bashku kanë vazhduar në drejtim të Obiliqit ku janë vendosur në motel “Sh.” dhe në momentin që ka hyrë në veturë të akuzuarit A. dhe Sh. e kanë pa se është me gjak mirëpo nuk ka mundur të flasë me të njëjtit, edhe pse paraprakisht lidhur me ngjarjen i’u kishte treguar i akuzuari L.B., ndërsa që lidhur me armën ka pohuar se e din vetëm se të nësërmen në mëngjes revolën e ka marrur i akuzuari Sh. që pas një kohe edhe i’u ka kthyer të akuzuarit L.B. dhe më vonë kjo armë është fshehur afër shtëpisë së L.B. në vendin e quajtur te bazeni. Ndërsa që të nesërmen e ngjarjes kritike të njëjtit kanë dalë nga moteli ku edhe kanë qëndruar dhe kanë vazhduar në drejtim te Prishtinës, Sh.i është ndalur në lagjen Vranjevc duke u arsyetuar se duhet të shkojë në punë, ndërsa që i akuzuari bashkë me L.B. dhe A. kanë vazhduar për tek lokali i A. dhe kur e kanë kuptuar se personi me të cilin janë përleshur ka vdekur, kanë vazhduar për në fshatin K. ku kanë qëndruar gjashtë ditë dhe në atë fshat i ka dërguar tani i akuzuari A. me veturën e tij i cili edhe njëherë tjetër ka shkuar dhe i’u ka dërguar ushqim në shtëpinë e axhës së L.B., ku ata ishin duke qëndruar. Në fund ka deklaruar se qëllim i hyrjes së tij në QT “A.M.” ka qenë që ta vjedhin kasaforten me para, dhe se është pënduar shumë për veprimin që ka bërë.

I akuzuari A.R. në senacën gjyqësore ka deklaruar se do të mbrohet në heshtje, qëndrim të njëjtë ka mbajtur edhe në deklaratën e dhënë në prokurori të datë 10.07.2015. Ndërsa që në deklaratën e dhënë në Polici më datë 09.04.2015 ka deklaruar se të akuzuarin L. e njëh pasi që dyqanet i kanë pasur afër, të akuzuarin L.B. me nofkën “C.” dhe Sh.C. i njëh pasi që kanë luajtur disa herë letra bashkë dhe se me datë 29.03.2015 diku rreth orës 23:00 me veturën e tij të tipit BMË X5 me targa 01-757CM së bashku me L. dhe L.B. më të cilët ka shkuar te hotel B., kanë marrur të akuzuarin Sh. dhe i ka dërguar te banesat e Arabëve, ndërsa që ai ka vazhduar të shëtitet i vetëm me veturë dhe pas një orë e gjysme ka shkuar përsëri në të njëjtin vend dhe i ka marrë të njëjtit dhe i ka dërguar te motel “Sh.” rrugës për Mitrovicë dhe ka vazhduar për në shtëpinë e tij. Më tutje ka shtuar se nuk e ka ditur se ku kanë shkuar të akuzuarit L., L.B. dhe Sh. kur të njëjtit i ka lënë te banesat e Arabëve, mirëpo të njëjtit i ka dërguar shoqërisht dhe gjatë kohës sa i ka bartur për në motel “Shpati” të njëjtit nuk kanë biseduar asgjë të pazakontë, ndërsa që i akuzuari L. ka qenë i lënduar mirëpo ky nuk e ka pyetur për arsyet e lëndimit, dhe se me të njëjtit nuk është takuar, mirëpo një person që është prezantuar si vëllau i tani të akuzuarit Sh. ka ardhur pas 4-5 ditësh nga ngjarja dhe i ka thënë a ke pare me ju gjet L. dhe L.B. për me ikë jashtë shtetit. Po ashtu ka shtuar se me heret të njëjtit asnjëherë nuk i ka dërguar nga një vend ne vendin tjetër, përveq se ndonjëherë, se bashku me te akuzuarin L. kanë shkuar në QT “A.M.”, ku i njëjti ka biseduar me të akuzuarin Sh..

Nga dëshmia e dëshmitarit G.P., dëshmi të cilën gjykata e ka vlerësuar si dëshmi të sigurtë dhe objektive në përputhje me deklaratën që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake dhe poashtu me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar dhe provave materiale të administruara në këtë çështje penale, e nga e cila dëshmi vërtetohet bindëdhëm fakti që i akuzuari Sh. ka qenë në dijeni për pazarin ditor që është arritur gjatë një dite pune dhe poashtu vendin ku ishin të vendosura të njëjtat, njohur këto të cilat edhe

u'a ka treguar bashkë të akuzuarve, em rastin e planifikimit të kryerjes se vjedhjes. Po ashtu faktin që në natën kritike i akuzuari Sh. e kishte thirrur të njëjtin duke i kërkuar që t'ia sjellë kuletën të cilën kinse i akuzuari Sh. e kishte harruar për çka edhe i'a ka sjellur në Prishtinë ku i'a kishte dorëzuar në hyrje të Prishtinës, pasi që at ditë paraprakisht i'a kishte kërkuar numrin dëshmitarit, e që vërteton bindshmë faktin se duke qenë pjesë e planifikimit të aktit të vjedhjes, ka marru veprime paraprake, qe me u siguru që në momentin kur ishte planifikuar të kryhet vjedhja të mos kishte persona brenda, parandaj dhe fillimisht tani dëshmitarit i'a ka marru numrin e tij të telefonit dhe me pastaj e ka lën kuletën, duke vërtetuar faktin se lënja e kuletës ishte një veprim i planifikuar me pare, me qëllim që duke ditur se ai është personi fundit që del nga lokali, të jetë në dijeni se kur do largohet i njëjti, dhe pastaj të kryhet vjedhja.

Gjykata e ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit V.C., dëshmi të cilën e ka vlerësuar si objektive dhe të sigurtë dhe në përputhje me deklaratën që e ka dhënë në procedurën paraprake gjegjësisht në deklaratën Polici të datë 30.05.2015 dhe në Prokurori të datë 26.06.2015, në dhe poashtu edhe me dëshminë e dëshmitarit G.P.e nga e cila dëshmi vërtetohet fakti që natën kritike bashkë me tani dëshmitarin G.P.janë takuar me të akuzuarin Sh. dhe të njëjtit i kanë dorëzuar kuletën të cilën ky kinse e kishte harruar në vendin e tij të punës, ani pse siq është vërtetuar nga ky dëshmitar saherë është harruar ndonjë gjësend nga ndonjë nga puntorëtr, të njëjtit janë kthyer vetë i kanë marrur, apo i kanë lënë derisa kanë ardhur në punë. Po ashtu nga ky dëshmitar vërtetohet fakti që derisa ditëve të tjera në mëngjes janë deponuar në bankë parat e pazarit të ditës paraprake, ndërsa që pazari i ditës së shtunë dhe të diele për shkak të mos punës së bakës ku janë deponuar paratë, kanë mbetur në sef dhe të njëjtat janë deponuar të hënën dhe se pazari më i lartë ka qenë gjatë fundjavëve, fakt ky që pakontestueshm e ka ditur i akuzuar Sh. siq vërtetohete dhe dëshmia e dëshmitarit G., andaj edhe vjedhja ishte planifikuar këtë ditë, gje që vërteton edhe rolin e të akuzuarit Sh. në planifikimin e vjedhjes, pasi që nga bashkë të akuzuarit vetëm ky ka qenë në njohuri se parat e pazarit nga dita e shtunë dhe diele, në bankë deponohen të hënën.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e të dëmtuarës A.R.e cila është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarës dhe të njëjën e ka gjetur si dëshmi objektive dhe të sigurtë, mirëpo ka vlerësuar se përmes kësaj dëshmie nuk mund të vërtetohet asnjë rrethane relevante sa i përket kësaj çështje penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe videoinxhizimet e marrura nga qendra tregtare "A.M." e nga të njëjtat pakontestueshm është vërtetuar fakti se në momentin kritik pasi që të akuzuarit kanë hyrë në kafiterinë "D.C." në ato momente është praqitur tani i ndjeri N.R., mirëpo siq vërtetohet nga këto videoinqizime njëri nga personat të cilët ishin duke kryer vjedhjen, e që siq është vërtetuar nga provat e administruara por edhe nga vetë pohimi i të akuzuarit L.S. se ishte pikërisht ai që ka shtënë me armë, në momentin kur është shtënë në drejtim të tani të ndjerit N., i njëjti ka qenë në një distancë të caktuar, e tillë që fillimisht prania e të njëjtit nuk është arritur të kapet nga kamerat që kanë qenë të vendosura në atë lokal, ndërsa që më pastaj tani i ndjeri paraqitet duke u ofruar i njëjti në drejtim të tani të akuzuarit L. në një pozitë të përkulur dhe me dorën në të cilën mbanë një mjetë, mirëpo që nuk vërhetë natyra dhe lloji i tij mirëpo që siq vërtetohet nga fotoalbumi mbi vendin e ngjarjes në afrësi të të ndjerit është evidentuar një thikë, ndërsa me tutje nga keto videoincizime vërtetohet që i akuzuari L. vazhdonë të shtënë në drejtim

të tani të ndjerit, deri në momentin se siç vërtetohet nga këto videoinqizime fillon përleshja fizike në hyrje të shankut për të vazhduar në brendi të tij, momente këto të cilat nuk janë kapur nga kamerat që kanë qenë të vendosura në atë lokal, mirëpo që në momentin e ikjes së tani të akuzuarit përsëri shihet tani i ndjeri në një pozitë gjysëm të rrëzuar për çka edhe goditet nga njëri tani të akuzuarit që siç është vërtetuar nga provat të administruara por edhe nga pohimi i të akuzuarit L.B. se pikërisht ai ka qenë i fundit që ka dalur nga shanku. Poashtu se i akuzuari L. ka shtënë në drejtim të tani të akuzuarit Nazmi pasi që i njëjti ishte duke ardhur në drejtim të tani të akuzuarit vërtetohet edhe nga numri predhave gjegjësisht tri predhat të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes që korrespondon me numrin e plagëve që ka pësuar i ndjeri siç vërtetohet nga rporti i autopsisë, ndërsa që siç nga videoinxhizimet tani i akuzuari L. ka filluar të shtënë në tani të ndjerin në një distancë të caktuar e që do të thotë që me gjuajtjen e parë në drejtim të tani të ndjerit i njëjti edhe është goditur dhe poashtu duke qe në se i akuzuari L. në vazhdimësi ka shtënë deri në momentin edhe kur është konfrontuar fizikisht, rezulton se tani i ndjeri plagët i ka marrur para se të vijë deri të kontakti fizik ndërmjet të akuzuarit L. dhe të ndjerit N.R.e që hedh poshtë kështu pretendimin e tani të akuzuarit L. se kinse pasi që është goditur me thikë nga tani i ndjeri, ka shtënë në drejtim të të njëjtit.

Gjykata ka vlerësuar edhe fotodokumentacionin mbi vendin e ngjarjes e nga i cili vërtetohet rruga që kanë ndjekur tani të akuzuarit L. dhe L.B. për të hyrë në qendrën tregtare A.M. nëpërmjet derës emergjente, ashtu siç i'u kishte treguar i akuzuari Sh.C., pastaj vendi i kryerjes së veprës penale në të cilin vend janë gjendur edhe sefi i vendosur në një çantë me madhësi e kontura të ngjajshme me ato që i akuzuari Sh. u'a kishte përshkruar tani të akuzuarve L.B. dhe L. të cilët duke qenë në dijeni të madhësisë së sefit të përshkruar nga i akuzuari Sh. kanë marrur edhe çantën për ta bartur të njëjtin dhe duke qenë në dijeni paraprakisht për vendin se ku ishte vendosur i njëjti e që gjithashtu edhe kjo rrethanë i'u ishte treguar nga i akuzuari Sh., e qe ua ka mundësuar tani të akuzuarve L. dhe L.B. që për një kohën të shkurtë të gjëjnë sefin dhe të arrijnë për ta vendosur në çantë, por që prania e tani të ndjerit N. e ka bërë të pamundur marrjen e sefit dhe njëherit i ka vendosur të njëjtit në rrethana që krejt qëllimin e tyre e ka reduktuar në Sh. nga identifikimi i tyre, ani pse duke u nisur nga distance në të cilën kanë shtënë në drejtim të tani të ndjerit N., vërtetohet qartë qëllimi për të mbrojtur setndin gjegjësisht sefin tani më të future në posedim. Poashtu nga ky dokumentacion vërtetohet fakti se në afërsi të trupit së tani të ndjerit është gjetur një thikë të cilën i njëjti e ka pasur në dorë në momentin kritik të zhvillimit të ngjarjes, e që është në përputhje edhe me videoinxhizimet në të cilat shihet se tani i ndjeri mban një mjet në dorë në momentin kur është dukë i'u afruar tani të akuzuarve mirëpo për shkak të cilësisë së videoinqizimeve është e pamundur të shihet lloji, madhësia dhe forma e të njëjtit, mirëpo që nga pozicioni dorës, është e qart se dicka është duke mbajtur në të.

Gjykata ka vlerësuar edhe fotodokumentacionin e datës 09.04.2015 e vendit ku është fshehur pistoleta pas kryerjes së veprës penale nga i cili ka vërtetuar bindshëm faktin se të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale e më qëllim të fshehjes së mjetit të kryerjes së veprës penale dhe të atyre si kryerës të kësaj vepre kanë fshehur pistoletën në anën lindore të rezervuarit të ujit në lagjen Kodra e Trimave – Prishtinë.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportin e autopsisë përmes të cilit janë vërtetuar edhe plagët që ka pësuar i ndjeri e poashtu edhe shkakun e vdekjes së të njëjtit.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportin mjekësor të datë 09.04.2015 në emër të tani të akuzuarit L.S., mirëpo nga ky raport nuk mund të vërtetohet koha se kur janë shkaktuar këto plagë pasi që ngjarja ka ndodhur me dt.30.03.2015, ndërsa që raporti është punuar pas një kohë, gjatë të cilës i akuzuari L. ka mundur të shkaktohen këto plagë edhe në ngjarje tjera, ndërsa që nisur nga natyra e plagëve të shkaktuara gjykata vlerëson se përshkrimi i tani të akuzuarit L. se është goditur tri herë nga tani i ndjeri bie ndesh me këtë konstatim pasi që siç konstatohet në këtë raport plagët janë të natyrës sipërfaqësore që konsistojnë në gërvishtje e që hyjnë në kuadër të lëndimeve të lehta trupore.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportin ligjor për thirrje telefonike dhe atenave të komunikimit të date 01.04.2015 i cili ka vërtetuar bindshëm faktin se i akuzuari Sh. i ka njohur të akuzuarit L. dhe L.B., dhe s'eme te njëjtit ka pasur shoqëri edhe më heret, dhe komunik të vazhdueshm me të njëjtit dhe në funksion të realizimit të planit të përgatitur paraprakisht, i akuzuari Sh. ka komunikuar me të akuzuarin L. edhe ditën kritike dhe atë disa herë para se të hyjnë për të kryer aktin e vjedhjes në A.M., e që kjo është në përputhje edhe me provat e tjera material dhe pohimet e të bashkëakuzuarit L. i cili ka deklaruar se ka komunikuar ditën kritike disa herë më të akuzuarin Sh. dhe atë lidhur me kryerjen e vjedhjes ashtu siç kishin rënë më parë dakord. Poashtu vërtetohet se i akuzuari Sh. në ora 00:21:15 ka qenë te rrethi e që siç është pohuar edhe nga vetë i akuzuari aty ishte edhe vendi deri ku ikishin dërguar tani të akuzuari L.B. dhe L. dhe ku ishin ndalur për t'i prituri anë pse i akuzuari Sh. ka pretenduar nuk e ka dite se ku kanë shkuar të njëjtit.

Gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është vërtetuar pjesërisht edhe nga mbrojtja e të akuzuarve Sh.C., L.S., L.B.dhe A.R. të cilët në procedurën paraprake por edhe në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor kanë deklaruar se paraprakisht ishin marrur vesh për vjedhjen që do të kryhej në qendren tregtare A.M.. I akuzuari Sh.C. e ka pranuar faktin se tani i akuzuari L.S. ka qenë bashkë me të akuzuarin A. dhe L.B.në QT "A.M." para ditës kritike dhe se e kanë pyetur lidhur me pazarin ditor që arrihet në atë kafiteri, poashtu ka pranuar faktin se në natën kritike të njëjtit e kanë marrur nga qendra tregtare "A.M." pas përfundimit të punës, e poashtu se e kishte thirrur menaxherin e lokalit meqenëse se sipas tij e ka harruar kuletën, dhe poashtu faktin se të akuzuarit L.B. dhe L. i ka takuar te rrethi në hyrje të Prishtinës kur të njëjtit e kishin kryer veprën penale, mirëpo siç ka pretenduar nuk e kanë ditur se ku kishin qenë të njëjtit dhe poashtu se bashkë më të njëjtit kanë qëndruar në një motel jashtë Prishtinës në drejtim të Obiliqit. Poashtu, edhe i akuzuari L.S. ka pranuar se paraprakisht se se së bashku me të akuzuarit Sh., L.B. dhe A. kanë planifikuar kryerjen e vjedhjes në qendrën tregtare "A.M." duke u marrur vesh edhe për ndarjen e shumës së parave pas kryerjes së aktit të vjedhjes dhe se në funksion të këtij qëllimi para natës kritike kanë qenë në këtë objekt gjithmonë të thirrur nga i akuzuari Sh. i cili edhe i ka treguar për shumën e parave, për vendin ku mbahen të njëjtat, për hyrjen dhe daljen emergjente. Poashtu edhe natën kritike së bashku me të akuzuarin A. dhe L.B. janë takuar dhe pasi që paraprakisht ishin marrur vesh me të akuzuarin Sh. kanë shkuar dhe kanë marrur të njëjtin në qendrën tregtare A.M. dhe se i njëjti siç I ka thënë tani të akuzuarit L. e ka lënë kuletën me qëllim që të sigurohet se në momentin kur ishte planifikuar koha e vjedhjes nuk do ishte askush në lokal. Poashtu edhe në natën kritike e ka pranuar se bashkë më të akuzuarin L.B. pasi që paraprakisht A. dhe Sh. i kanë dërguar deri të rrethi i parë-banesat e Arabëve, kanë hyrë në qendrën tregtare "A.M." dhe se gjatë aktit të vjedhjes një person ka ardhur në drejtim të tyre

mirëpasi siç ka pretenduar i akuzuari i njëjti ka filluar ta sulmojë me thikë ndërsa që ky në vetëmbrojtje ka shtënë në drejtim të të njëjti me revolën të cilën i'a kishtë marrur të akuzuarit L.B. dhe që për të njëjtën ka qenë në dijeni A. dhe Sh.. Edhe i akuzuari L.B. ka përshkruar në mënyrë të ngjashme palnifikimin e vjedhjes, njërezit me të cilët ka bashkëpunuar dhe poashtu dinamikën e ngjarjes në momentin kritik dhe veprimet pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa sa i përket të akuzuarit A.R. i njëjti përveq që ka pranuar faktin se i njuhë të akuzuarit në deklaratën që ka dhënë në procedurën paraprake e ka pohuar faktin se të njëjti i ka dërguar deri te banesat e Arabëve, mirëpo siç ka theksuar i ka dërguar shoqërisht dhe nuk e ka ditur se cili është qëllimi dhe ku do të shkojë të njëjtit, dhe poashtu i ka bartur deri te hotel "Shpati" pa ditur se ku kish qenë të njëjtit.

Gjykata ka vlerësuar edhe formularin e të dhënave për transferë bankarë për të ndjerin N.R. të datë 18.05.2007, fletëlëshimin me emër të ndjerit N.Z., dokumentacioni mjekësorë në emër të të ndjerit, mirëpo nga të njëjtat nuk ka vërtetuar ndonjë rrethanë relevante në këtë çështje penale juridike.

Gjykata poashtu ka vlerësuar edhe propozimet e mbrojtësit të akuzuarit L.S. për dëgjimin në cilësinë e dëshmitarëve të policëve A.Sh. dhe K.H. e poashtu edhe polici A.R. si përpunues i memorandumit zyrtar të datë 07.04.2015, dëshmitarët L. K. dhe A.A. meqë të njëjtit kanë punuar si kamarier në natën kritike, dëshmitari V.K. si koleg i tani të ndjerit N.R. si dhe eksperti ligjor F.D., mirëpo këto propozime i ka gjetur të pabazuara dhe për këtë shkak edhe i ka refuzuar meqenëse këto propozime nuk janë shoqëruar me arsyetime se përse këta dëshmitarë duhet të dëgjohen, gjegjësisht se cilat rrethana do të vërtetoheshin me dëgjimin e këtyre dëshmitarëve në këtë çështje penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit Sh.C., mirëpo të njëjten e ka vlerësuar të pabazuar dhe në funksion të shmangies së përgjegjësisë penale për veprën penale për të cilën akuzohet. Pretendimi i mbrojtjes se i akuzuari Sh. nuk e ka ditur dhe paraprakisht nuk ka biseduar dhe nuk është marrur vesh me tani të bashkëakuzuarit për kryerjen e vjedhjes, është i paqendrueshëm pasi që siç është vërtetuar nga provat e administruar në këtë çështje penale, nga pohimet e të bashkëakuzuarve dhe pjesërisht edhe nga pohimet e ketij të akuzuarit pohime këto të cila janë në pajtim me pohimet e të akuzuarve të tjerë sa i përket rrethanave të cilat ky i akuzuar i ka pranuar, e që pjesërisht ka shëbyre për vëtetimin e gjendjes faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa rrethan tjera janë vërtetuar nga provat e admistruara, siq janë lidhje shoqërore me tani të bashkëakuzuarit, me të cilën edhe ka planifikuar vjedhjen, duke ua propozuar iden për hyrje, pasi që ka qenë në dijeni për shume e parave, faktin që të shtunë dhe të dielen nuk deponohen, gjë që vjedhja është kryer ditën e diele, komunikim me të akuzuarin L. ditën kritike, pastaj tregimi për mënyrëjn hyrjes përmes derës emergjente, vendi ku është sefi, pastaj lënia e kuletës me qëllim që të i kërkonte menagjerit sjelljen e të njëjtes, duke ja marrur numrin paraprakisht, po ashtu shoqërimi i të bashkëakuzuarve Leurim dhe L.B. deri në një distanc të caktuar dhe shoqërim më të njëjtit pas kryerjes së ngjarjes kritike, dhe qenia në dijeni për armën të cilën e kishin të akuzuarit L. dhe L.B., vërteton se i akuzuarit Sh. ka qenë i përfshirë që nga fillimi në kryerjen e kësaj veprës penale dhe se kontributi i tij është thelbësor në kryerjen e veprës penale përkatësisht në realizimin e planit të përbashkët, pasi që nëse i akuzuari Sh. nuk do ta kryente detyrën e vet gjegjësisht veprimet tani më të vërtetuar bindhsmë nga provat e administruara, vepra penale nuk do

të kryhej, apo nuk do të kryhej ashtu siç ka qenë e planifikuar, nga këta të akuzuar me vetëdije dhe me dëshirë. Andaj të gjitha këto veprime nuk mbesin në kuadër të veprës penale të ndihmës si një nga format e bashkëpunimit e që konsiston në dhënien e këshillave apo udhëzimeve si kryhet vepra penale, pasi që në rastin konkret i akuzuari Sh. është inicuesi pra formëzuesi i idesë për të hyrë e vjedhur në lokalin ku ai ka punuar, dhe ka marrë pjesë në planin e përgaditur për mënyrën e kohës se vjedhjes, kohën s ekur do të kryhej vjedhja, pastaj dërgimi i tani të akuzuarve deri te banesat e Arabëve dhe pritja pas kryerjes së vjedhjes.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit L.B.mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje penale dhe me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale veprën penale për të cilën akuzohet. Pretendimi i mbrojtësit të tani të akuzuarit se i njëjti nuk ka vepruar në kushtet e bashkëkryerjes me tani të akuzuarin L. është i pabazuar pasi që në momentin e shtënjes ka qenë bashkë me të akuzuarin L. siç ka qenë prezent edhe gjatë tërë aktit të kryerjes së vjedhjes, e poashtu ka qenë prezent dhe pjesëmarrës në gjithë aktin e planifikimit të vjedhjes, ndërsa që e ka ditur se i akuzuari L. në momentin e hyrjes ka pasur armë me vete, e të cilën armë i'a kishtë dhënë i akuzuari L.B. dhe se fakti pse i akuzuari L.B. nuk i kishtë mbajtur armën edhe gjatë hyrjes për të vjedhur ishte sepse nuk kishtë ku ta mbante. Andaj posedimi i armës deri në një moment të caktuar dhe fakti se ishte një penges objektiv që kishtë penguar të akuzuarin L.B. që të vazhdojë ta mbajë në posedim armën më ç'rast edhe i'a kishtë dhënë të akuzuarit L., manifeston gatishmërinë e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale dhe mposhtjen e rezistencës në rast se pengohet në aktin e vjedhjes apo marrjen e sendit tanimë të futur në posedim siç ka ndodhur në rastin konkret ku pasi që dy të akuzuarit L.B. dhe L. kanë hyrë në lokalin "D.C." kanë arritur që sefin ta fusin në çantë dhe që në momentin kur është paraqitur tani i ndjeri N.R.në funksion dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë kanë përdorur forcën ashtu që i akuzuari L. ka shtënë në drejtim të të ndjerit.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit L. mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje penale. Pretendimi i të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij se tani i akuzuari L. ka hyrë për të vjedhur dhe në asnjë moment nuk ka pasur për qëllim privimin nga jeta të tani të ndjerit N.R., gjykata e vlerëson si të pabazuar pasi që së pari, në rast se qëllimi i të akuzuarit do të ishte privimi nga jeta i tani të ndjerit N.R., atëherë i akuzuari L. dhe të bashkëakuzuarit tjerë do të akuzoheshin për kryerjen e një vepre tjetër penale, dhe se i akuzuari L. dhe të bashkëakuzuarit tjerë nuk kanë qenë të akuzuar se kanë hyrën në qendrën tregtare "A.M." në kafiterin "D.C." me qëllim që ta privojnë nga jeta tani të ndjerin N., andaj nuk është kontestues fakti se qëllimi i të njëjtëve ka qenë për vjedhur sefin në kafiterin "D.C.". së dyti, Kodi Penal i Republikës së Kosovës në nenin 328 par.1ka përshtuar figurën e veprës penale vjedhja grabitqare e sipas këtij paragrafi "kushdo që i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes..." pra nuk është kontestuese fakti se tani të akuzuarit kanë hyrë për të vjedhë shumën e parave që sipas tyre ka qenë e vendosur në sef, dhe për të vazhduar me po të njëjtit paragraf "...me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdorë forcën apo kanosjen serioze për ta sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër..." pra qëllimi i të akuzuarit L. ka qenë mbajtja e pasurisë tanimë të futur në posedim e që vërtetohet edhe nga fakti se tani të akuzuarit kishin arritur që sefin ta fusin në çantë dhe

se qëllimin e tij për ta mbajtur pasurinë e vjedhur e ka manifestuar në dy momente, së pari kur ka marrur armën nga i akuzuari L.B. dhe së dyti kur të njëjten e ka përdorur ashtu që ka shtënë në drejtim të ndjerit N.R. i cili ka qenë duke ardhur në drejtim të tij dhe të akuzuarit L.B.. Poashtu pretendimi i të akuzuarit se i njëjti ka shtënë në të ndjerin pasi që fillimisht ka qenë i sulmuar me thikë nga i njëjti, është i pabazuar pasi që siç vërtetohet edhe nga video inxhizimet e administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale i akuzuari L. ka filluar të shtënë në tani të ndjerin N. në një distancë e cila nuk ka paraqit rrezik për jetën e tij edhe duke marrur parasush faktin se tani i ndjeri në dorë ka mbajtur thikë. Sipas KPRK-së për t'u gjendur në kushtet e mbrojtjes së nevojshme është e domosdoshme që mbrojtja të jetë e domosdoshme për zbrabzjen e sulmit, sulm i cili duhet të jetë i kundërligjshëm, real dhe i atë çastshëm ndaj personit që kryen mbrojtjen apo personit tjetër dhe që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikun që paraqet sulmi dhe të gjitha këto elemente duhet të përmbushen në mënyrë komulative dhe në rastin konkret nuk jemi në përmbushje të këtyre kushteve qoftë veq e veq, e qoftë të gjitha së bashku siç kërkohet nga kjo dispozitë ligjore pasi që fillimisht tani i akuzuari L. nuk ka qenë fare i sulmuar e aq më pak i sulmuar në mënyrë të kundërligjshme. Poashtu sulmi nuk ka qenë as real dhe as i atëqastshëm për shkak se siç u tha edhe më lartë i akuzuari L. ka filluar të shtënë në drejtim të tani të ndjerit Nazmi në një distancë që nuk ka paraqitur rrezik për të, prandaj edhe në qoftë se i akuzuari L. do të kishte vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret, përsëri karakteri i mbrojtjes gjegjësisht gjuajtja në tani të ndjerin në një distancë të tillë është në tanësi jo në proporcion me shkëllën e rrezikut që ka mundur të paraqes ky i fundit i cili në ato momente ka qenë duke ardhur në drejtim të tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A. mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje penale. Pretendimi se në rastin e të akuzuarit A. nuk jemi në kushtet e ndihmës si një nga format e bashkëpunimit për shkak se siç pretendon mbrojtja i akuzuari A. vetëm i ka dërguar te banesat e Arabëve e që kjo është në një distancë të largët nga qendra tregtare "A.M." është e pabazuar pasi që siç është vërtetuar nga provat e administruara i akuzuari A. ka qenë në dijeni që në planifikimin e kryerjes së veprës penale, poashtu edhe para natës kritike ka qenë me të akuzuarin L. në lokalit D.C. e që qëllimi i shkuarjes ka qenë pikërisht që të shohin se cilat janë mundësitë dhe në çfarë drejtimi duhet rrugëtuar natën kur ishte planifikuar vjedhja, e poashtu edhe natën kritike ai është takuar me të akuzuarit L. e L.B. dhe me veturën e tij kanë shkuar e kanë marrur tani të akuzuarin Sh. në qendrën tregtare A.M. dhe paashtu duke qenë paraprakisht të dakorduar i ka pritur derisa është kryer akti i vjedhjes dhe në të njëjtën kohë pas kryerjes së vjedhjes i ka dërguar në një motel në dalje të Prishtinës dhe ka qëndruar me të njëjtit deri në ditën e nesërme, pra i akuzuari A. ka pasur për detyrë në bazë të marrëveshjes paraprake që t'i i dërgoj dhe të i pres personat tjerë me automobile dhe pasi të marrin paratë t'i transportojë deri në vendin e caktuar dhe pastaj paratë t'i ndajnë mes veti. Po ashtu sa i përket pretendimit se i akuzuari A. nuk e ka ditur se i akuzuari L.B. është poashtu pretendim në tërësi i pabazuar pasi që i akuzuari A. e ka ditur dhe në bazë të rrethanave në të cilat ka vepruar është dashur ta dijë se i akuzuari L.B. është i armatosur duke u nisur nga fakti që i akuzuari A. ka qëndruar në vazhdimësi me të akuzuarit L.B. e L. që nga momenti kur ishin takuar diku rreth orës 19:00 në lokalit "h. i d." dhe me të njëjtin ka qëndruar deri në momentin kur të njëjtit kishin shkuar për të kryer vjedhjen, ndërsa që dijeninë e të njëjtit mbi armën

e poseduar nga i akuzuari L.B. e kanë pohuar edhe të bashkëakuzuarit L. dhe L.B. dhe fakti që i njëjti e ka ditur se të njëjtit kanë armë më vete, po ashtu ka shfaqur miratimin e tij dhe vendosmërin e tij që të mposhtet cdo penges që mund ta haset me rastin kryerjes së vjedhjes dhe po ashtu është e rëndësishme të thekësohet fakti që i akuzuari A. shfaqët në gjithë zingjirin e zhvillimit, pra që nga planifikimi, dhe pastaj ekzekutimi planit, dergimi deri te një distanc e caktuar dhe pastja pritja ashtu siq ishin marrur vesh paraprakisht.

Këto kanë qenë arsyet në bazë të cilave gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal gjykata në raport me të akuzuarit Sh.C., L.B., L.S. dhe A.R., është përcaktuar me denim me burg, i cili është në kufijë të rregulluara për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë. Gjkata duke vendosur mbi denimin për të akuzuarit Sh.C., L.B., L.S. dhe A.R., ka vlerësuar të gjitha rrethanat ato rëndësuese dhe lehtësuese të cilat ndikojnë në lartësinë dhe ultësin e denimit, nga rrethanat rëndësuese për të akuzuarit Sh.C., L.B., L.S. dhe A.R. ka marrur motivin për kryerjen e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale si dhe shkallën e përgjegjësisë penale, ndërsa që për të akuzuarit L.B. dhe L.S. ka marrur si rrethanë rëndësuese edhe sjellën e të njëjtëve para kryerjes së veprave penale gjegjësisht se të njëjtit janë recidivist, duke qenë se të njëjtit edhe më herët janë dënuar, gjykuar ose janë në procedurë penale për vepra penale të karakterit të ngajshëm, e të kryera brenda një periudhe të shkurtër kohore. Kurse nga rrethanat lehtësuese për të gjithë të akuzuarit ka marr moshën e re të tyre, gjendjen e dobët ekonomike, nivelin e ulët të shkollimit, sjelljen e tyre korrekte gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, ndërsa që për të akuzuarit L.B. dhe L.S. e ka marr pjesërisht pranimin e veprimeve inkriminuese dhe kërkim faljen në drejtim të familjes së palës së dëmtuar, keqardhje për rastin që ka ndodh. Andaj duke patur parasysh rrethanat e sipërmendura të akuzuarit për veprat penale për të cilat i ka shpall fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke pasur parasysh intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera, e duke qenë e bindur se ky denim është në harmoni me intezitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera dhe shkallën së përgjegjësisë penale të kryer dhe se duhet të shërbej si preventivë gjenerale, posaqërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë dhe diciplinës së qytetarëve i gjykoj si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjkata është e bindur se me shqiptimin e denimeve, në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit e rregulluar me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrur konform nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Të akuzuarëve Sh.C., L.B. dhe L.S. i'u është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi konform nenit 367 par.2 lidhur me par.7 të KPPRK-së, dhe arsyet për vazhdimin e paraburgimit janë dhënë në aktvendimin e veçantë.

Vendimi që e dëmtuara A.R. të udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasuroro - juridike është marr konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi që të akuzuarit janë obliguar që të paguajë gjykatës në emër të paushallit gjyqësorë si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të akuzuarëve.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.125/16, të dt:29.11.2017

Kryetarja e trupit-gjyqtarja
Shadije Gërguri

Bashkëpuntori profesional
Driton Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.